Terre des hommes
tdh.ch

Komunitet mbështetës, familje bashkëpunuese, fëmijë të mbrojtur

(nga komuniteti për komunitetin)

with funding from
Austrian Development Cooperation
NORWEGIAN MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC
unicef
OAK FOUNDATION
medicorfoundation
SWISSLOS Basel-Landschaft

AUTORE: MA, MSc Merita Meçe

NË BASHKËPUNIM ME: Arbi Basho, Besjana Brahja, Ornela Hamataj, Saimir Kazanxhiu

REDAKTOR LETRAR: Maksim Sinemati

DISENJIMI & FAQOSJA NGA: Eduart Strazimiri

PËRGATITJA PËR BOTIM NGA: © 2012 Terre des hommes

Përmbajtja

Falënderim 5

Parathënie 6

Fjalor 7

I. Rëndësia e Përfshirjes së Komunitetit në Mbrojtjen e Fëmijëve 9

1.1 Ç'kuptojmë me komunitet? 10

1.1.1 Përkufizimi i "komunitetit në nevojë" 10

1.2 Roli i komunitetit në nevojë në mbrojtjen e fëmijëve 12

1.3 Modeli i ndërhyrjes së "Terre des hommes" në komunitetin në nevojë 13

1.3.1 Pse u zgjodh ky model ndërhyrjeje? 14

II. Mobilizimi dhe Fuqizimi i Komunitetit në Nevojë për Mbrojtjen e Fëmijëve 17

2.1 Vështrim i përgjithshëm 18

2.2 Hapat e ndjekur në mobilizimin e komunitetit 19

2.2.1 Planifikimi i mobilizimit të komunitetit 19

2.2.1.1 Profili i komunitetit dhe hyrja në komunitet 19

2.2.1.2 Vendosja e kontakteve me komunitetin 20

2.2.1.3 Krijimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit (GKK) 21

2.2.1.4 Identifikimi me pjesëmarrje i nevojave të komunitetit 22

2.3 Mbështetja dhe fuqizimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit 24

2.3.1 Informimi i komunitetit mbi rolin e Grupit të Këshillimit të Komunitetit 25

2.3.2 Takime/konsultime me anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit 26

2.3.3 Ngritja e kapaciteteve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit 27

2.3.4 Mbështetja e aktiviteteve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit 28

2.3.4.1 Aktivitete ndërgjegjësuese me të rriturit 28

2.3.4.2 Aktivitete me fëmijët 30

2.3.4.3 Monitorimi i aktiviteteve 31

III. Promovimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit 33
3.1 Fletëpalosje me aktivitetet e kryera nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit 34
3.2 Tavolina të rrumbullakta të Grupit të Këshillimit të Komunitetit me përfaqësues të pushtetit vendor 35
3.3 Pjesëmarrja e Grupit të Këshillimit të Komunitetit në nivel rajonal 36
3.4 Promovimi i rolit të Grupit të Këshillimit të Komunitetit në nivel kombëtar 37
3.5 Shkëmbim përvojash mes Grupeve të Këshillimit të Komunitetit 38

IV. Grupi i Këshillimit të Komunitetit si Pjesë Përbërëse e Rrjetit Lokal për Mbrojtjen e Fëmijëve 41
4.1 Bashkëpunimi me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës 43
4.2 Bashkëpunimi me shkollën/psikologun shkollor 44
4.3 Bashkëpunimi me institucionet e shërbimit shoqëror rezidencial 45
4.4 Bashkëpunimi me Drejtorinë e Shërbimit Publik 46
4.5 Bashkëpunimi me OJF-të lokale 46
4.5.1 Kredia e vogël e kushtëzuar - një model pozitiv për shkollimin e fëmijëve 46
4.5.1.1 Vlerësimi i nevojave të familjeve për të marrë kredi të kushtëzuar 47
4.5.1.2 Rritja e kapaciteteve të familjes në menaxhimin e të ardhurave 48
4.5.1.3 Monitorimi i ecurisë së aktivitetit familjar dhe të shkollimit të fëmijëve 49

V. Vlerësimi i Modelit të Ndërhyrjes 50
5.1 Vlerësimi nga anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit 52
5.2 Vlerësimi nga anëtarët e komunitetit 54
5.3 Vlerësimi nga fëmijët 55
5.4 Vlerësimi nga bashkëpunëtorët lokalë publikë dhe jopublikë 56
5.4.1 Vlerësimi nga institucionet publike 56
5.4.2 Vlerësimi nga institucionet jopublike 57

VI. Mësime të Nxjerra 59

Shtojca 63
Shtojca 1: Profili i komunitetit 64
Shtojca 2: Formë monitorimi aktiviteti 66
Shtojca 3: Formë referimi e familjes për të përfituar kredinë e kushtëzuar 70
Shtojca 4: Cikli i procesit të kredisë së vogël të kushtëzuar 74
Shtojca 5: Formë monitorimi 75

Falënderim

Ne u shprehim mirënjohjen tonë të madhe anëtarëve të Grupeve të Këshillimit të Komunitetit të qyteteve Elbasan (Rrapishtë), Durrës (Shkozet dhe NISH-Tulla) dhe Pogradec (Lagjia 4 dhe 5); të fshatrave Baltëz (komuna Dërmenas), Levan (komuna Levan), Rom (komuna Qendër), Novoselë (komuna Novoselë); banorëve të këtyre komuniteteve, prindërve dhe fëmijëve për kohën e çmuar, mendimet e besimin që na dhanë dhe bashkëpunimin frytdhënës që patëm në zbatimin e projektit "*Zhvillimi i rrjetit për mbrojtjen e fëmijëve*" (2009-2012). Ne falënderojmë gjithashtu përfaqësuesit e pushtetit vendor, punonjësit e institucioneve të ndryshme publike dhe vendore si Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrën Arsimore, Drejtorinë e Shëndetit Publik/qendrat shëndetësore, institucionet e shërbimit shoqëror rezidencial, Zyrën e Punësimit, si edhe punonjësit e institucioneve jopublike dhe të shoqatave jofitimprurëse që e lehtësuan punën tonë në terren, duke na ndihmuar për rritjen e kapaciteteve të komuniteteve në nevojë dhe për përballimin e sfidave të ndryshme, me qëllim për të sjellë ndryshime pozitive në qëndrimet dhe praktikat e komunitetit lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

Ne gjithashtu falënderojmë ekipin e ndërmjetësve me komunitetin të fondacionit "Terre des hommes" për punën e tij të palodhur në mobilizimin dhe fuqizimin e komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Duke punuar bashkarisht dhe duke u mbështetur në pikat e forta të komunitetit, ne riaktivizuam dhe gjallëruam përpjekjet e tij kolektive për të patur një përgjegjësi më të madhe, me qëllim për të ofruar një mjedis të mbrojtur e të sigurt për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve.

Parathënie

Ky botim dokumenton përpjekjet e përbashkëta të ekipit të fondacionit "Terre des hommes" me anëtarët e Grupeve të Këshillimit të Komunietit, prindërit, fëmijët e banorët e komuniteteve në nevojë në qytetet Elbasan (Rrapishtë), Durrës (Shkozet dhe NISH-Tulla), Pogradec (Lagjet 4 dhe 5), në fshatrat Baltëz (komuna Dërmenas), Levan (komuna Levan), Rom (komuna Qendër), Novoselë (komuna Novoselë), përfaqësuesit e pushtetit vendor të këtyre njësive vendore dhe punonjësit e institucioneve publike e jopublike, me qëllim mobilizimin dhe fuqizimin e komuniteteve në nevojë për mbrojtjen e fëmijëve në kuadrin e zbatimit të projektit "*Zhvillimi i rrjetit për mbrojtjen e fëmijëve*" (2009-2012).

Mbrojtja e fëmijëve dhe respektimi i të drejtave të tyre kërkon që vizioni dhe misioni ynë, vlerat dhe modeli gjithëpërfshirës i ndërhyrjes, aftësitë ndërvepruese dhe analizuese të jenë pjesë e rrugëtimit të përbashkët të shumë bashkëpunëtorëve, me qëllim për të aritur rezultate pozitive lidhur me nevojat e fëmijëve dhe të familjeve të tyre. Kjo do të thotë se qëllimi, objektivat dhe përgjegjësitë e çdo bashkëpunëtori të komunitetit duhet t'u shërbejnë përfitimeve reciproke, pasi asnjë aktor i vetëm nuk do të mund ta arrijë atë që dëshiron, pa ndihmën e të tjerëve. Marrëdhëniet e ndërsjella, të ngritura jo mbi bashkëpunime rastësore, por mbi lidhje të qëndrueshme dhe të orientuara drejt nevojave të caktuara, janë thelbësore, me qëllim për t'i forcuar lidhjet me komunitetin, për t'i përdorur më mirë burimet e tij, për të rritur kapacitetet e tij dhe për të patur një përgjegjësi kolektive në rritjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Përvoja pozitive e arritur gjatë zbatimit të këtij projekti është fryt i punës së të gjithë aktorëve dhe bashkëpunëtorëve, të cilët kanë qenë pjesë aktive e gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme dhe bashkëkohore, duke u bazuar tek interesi më i lartë i fëmijës!

Fjalor

- ***Bashkia*** përfaqëson një unitet administrativ territorial dhe bashkësi banorësh, kryesisht në zonat urbane dhe, në raste të veçanta, përfshin edhe në zonat rurale[1];
- ***Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore*** janë njësi arsimore vendore në nivel qarku/rrethi, të cilat përfaqësojnë Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës në nivel vendor dhe janë përgjegjëse për funksionimin e institucioneve arsimore (shkollave) brenda juridiksionit të tyre[2];
- ***Familje të varfra*** janë ato familje që nuk kanë të ardhura materiale ose/dhe financiare ose i kanë ato të pamjaftueshme, duke pasur parasysh veprimtarinë ekonomike dhe programet e tjera të mbrojtjes shoqërore e financiare[3];
- **Fëmijë** është çdo njeri i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç[4];
- ***Fëmijë në rrezik*** është fëmija, të cilit i mohohen ose i cënohen të drejtat dhe mbrojtja e parashikuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi[5];
- ***Grupi multidisiplinar*** është i koordinuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në nivel bashkie/komune dhe përbëhet nga disa aktorë lokalë publikë e jopublikë;
- ***Komuna*** përfaqëson një unitet administrativ territorial dhe bashkësi banorësh, kryesisht në zonat rurale dhe, në raste të veçanta, edhe në zonat urbane[6];
- ***Mbrojta e fëmijëve*** synon parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhencës së fëmijëve, duke përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktikat e dëmshme tradicionale, si gjymtimin e organeve gjenitale dhe martesat e fëmijëve[7];
- ***Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës*** funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës dhe ka si detyrë vlerësimin, monitorimin, mbrojtjen, referimin e fëmijëve në rrezik, bashkërendimin e grupit multidisiplinar, ndërgjegjësimin e komunitetit, etj.[8];
- ***OJF*** – Organizata Jo-Fitimprurëse, e krijuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka si objekt të saj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve[9];
- ***Shërbime të përkujdesit shoqëror*** janë shërbimet që u ofrohen individëve, familjeve, grupeve në nevojë dhe komuniteteve për plotësimin e nevojave të tyre jetësore[10];

1 Ligji 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore";
2 Ligji 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë";
3 Ligji 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore";
4 Ligji 10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës";
5 ibid
6 Ligji 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore";
7 Ligji 10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës";
8 ibid;
9 ibid;
10 Ligji 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore";

Rëndësia e Përfshirjes
së Komunitetit
në Mbrojtjen e Fëmijëve

Mbrojtja e fëmijëve, duke u bazuar në të drejtën e tyre për të pasur një jetë të sigurt dhe zhvillim të shëndetshëm, nuk do të ishte e frytshme, nëse prindërit e tyre dhe anëtarët e komunitetit nuk do ta kuptonin rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve dhe nuk do të bashkëpunonin për të ofruar një mjedis mbështetës për fëmijët dhe familjet e tyre. Kjo kërkon përfshirjen më të madhe të komunitetit në ndërhyrjet e përqendruara te fëmijët dhe familja, duke inkurajuar krijimin e bashkëpunimeve efektive me përgjegjësi të përbashkët me struktura e agjenci të tjera, duke zvogëluar barrierat e bashkëpunimit, duke forcuar kulturën e komunikimit dhe duke rritur nivelin e ndërgjegjësimit të anëtarëve të komunitetit për identifikimin e hershëm të formave të ndryshme të abuzimit me fëmijët dhe raportimin e tyre, me qëllim për t'iu kundërpërgjigjur në kohë praktikave abuzive në drejtim të fëmijëve.

1.1 Ç'kuptojmë me komunitet?

Nga një vështrim i përgjithshëm, "marrëdhëniet në komunitet" janë dinamike, prandaj edhe përkufizimi i fjalës "komunitet" është paksa elastik. Në përgjithësi, me fjalën *komunitet* kuptojmë ndërthurjen e tre elementeve kryesorë: a) vendin ose territorin gjeografik; b) rrjetet shoqërore ose institucionet që ndërveprojnë rregullisht me banorët; c) ndërveprimin shoqëror për probleme me interes të përbashkët[11]. I parë nga jashtë, një komunitet mund të jetë i ndarë në nëngrupe ose kategori; mund të jetë një komunitet përfshirës e bashkëpunues për anëtarët e tij dhe bllokues ose diskriminues për nëngrupet ose kategoritë e përjashtuara nga ana shoqërore.

1.1.1 Përkufizimi i "komunitetit në nevojë"

Koncepti *komunitet në nevojë* është rrjedhojë e ndërthurjes së disa karakteristikave të disa nëngrupeve ose kategorive të veçanta të komunitetit të përjashtuara nga ana shoqërore, varfërisë, diskriminimit dhe neglizhencës. Faktorët nxitës të përjashtimit shoqëror lidhen me institucionet, proceset, normat dhe qëndrimet e shoqërisë, duke ndikuar mbi një sërë problemesh të ndërlikuara dhe të përcaktuara nga shkaqe strukturore[12]. Lidhja mes përjashtimit shoqëror, komuniteteve në nevojë, shkaqeve dhe faktorëve paraqitet në figurën e mëposhtme:

11 Wilkinson, K. P (1991), "The community in rural America, New York: Greenwood Press";
12 UNDP (2011), "Beyond transition: towards inclusive societies, Regional Human Development Report";

Figura 1: Lidhja mes përjashtimit social, komuniteteve në nevojë, shkaqeve dhe faktorëve të tyre[13]



Pra, komuniteti në nevojë është i ekspozuar ndaj formave të ndryshme të mohimit, të abuzimit ose të shkeljes së të drejtave të tij, duke shkaktuar një gjendje të ulët social-ekonomike të banorëve të tij, një nivel të ulët arsimor, përjashtim shoqëror dhe diskriminim. Një komunitet i tillë është edhe komuniteti rom[14], tek i cili u përqendrua ndërhyrja kryesore e fondacionit "Terre des hommes" për mobilizimin dhe fuqizimin e tij në mbrojtjen e fëmijëve.

13 UNDP (2011) Beyond transition: towards inclusive societies, Regional Human Development Report;
14 Raport i veçantë Nr. 4 i Avokatit të Popullit "Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri", 2009

- *58% e grave rome dinë shkrim e këndim kundrejt 96% të grave jorome;*
- *66% e burrave romë dinë shkrim e këndim kundrejt 98% të burrave joromë;*
- *3,3 herë më të ulëta janë të ardhurat e një familjeje rome, duke e krahasuar me të ardhurat e një familjeje jorome;*
- *71% e popullsisë rome është e papunë krahasuar me 15,8% të nivelit kombëtar të papunësisë;*
- *92% e romëve e kanë të vështirë të gjejnë punë nga mungesa e informacionit;*
- *25% e romëve kanë të ardhura të pamjaftueshme për të blerë ilaçe*

- *10% e fëmijëve romë ndjekin arsimin parashkollor;*
- *62% e fëmijëve romë dinë shkrim e këndim, kundrejt 97% të fëmijëve joromë që dinë shkrim e këndim;*
- *Vaksinimi i fëmijëve romë të moshës 1-4 vjeç mbetet problematik;*
- *Dhuna në familjet rome është e lartë;*
- *Trafikimi i fëmijëve romë dhe i vajzave rome është çështje serioze;*
- *Përfshirja e fëmijëve romë në lypje të detyruar, mbledhje kanaçesh, etj, është shqetësuese;*

1.2 Roli i komunitetit në nevojë në mbrojtjen e fëmijëve

Njeriu si krijesë shoqërore jeton dhe zhvillohet në një mjedis të caktuar, ku bashkëveprimi i ndërsjellë mes tyre përcakton veçoritë e familjes dhe karakteristikat e mbrojtjes së fëmijëve.

Figura 2: Modeli ekologjik



Sipas modelit ekologjik[15] (*Figura 2*), marrëdhënia familje-individ është e rrënjosur në komunitet, sepse sjelljet dhe qëndrimet e individit janë të lidhura ngushtë me ato të komunitetit. Prandaj, normat dhe rregullat e komunitetit ndikojnë jo vetëm te sjellja e prindërve ndaj fëmijëve të tyre, por edhe te mënyra se si ata kërkojnë ndihmë te të tjerët për probleme të fëmijëve të tyre.

Por ndikimi i komunitetit në marrëdhëniet prind-fëmijë dhe përgjegjësinë prindërore ndodh në disa mënyra: a) shqetësimi i prindërve mbi sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve të tyre mund të shtohet ose të pakësohet në varësi të nivelit të izolimit shoqëror dhe të abuzimit me

15 "Terre des hommes" dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (2009) "Mbrojtja e fëmijëve – Manual për shkolla"

fëmijët. Në varësi të mjedisit, zhvillimi i fëmijëve mund të jetë ose i shëndetshëm ose në rrezik të lartë psikologjik e fizik; b) tiparet dhe veçoritë e komunitetit mund të inkurajojnë ose të pengojnë përshtatjen dhe integrimin e familjeve që jetojnë aty; c) cilësia e jetës në komunitet varet nga ndërthurja e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Për shembull, në komunitetet e varfra dhe të diskriminuara nga ana social-ekonomike, me nivel të ulët arsimor, me nivel të lartë papunësie, me një numër të madh fëmijësh në krahasim me të rriturit, keqtrajtimi dhe neglizhenca e fëmijëve është e lartë; d) format e ndryshme të abuzimit, shfrytëzimit, neglizhencës dhe të keqtrajtimit të fëmijëve mund të parandalohen, duke forcuar rolin prindëror në familjet në rrezik dhe duke përmirësuar bashkëpunimin për mbrojtjen e fëmijëve në komunitetet në nevojë[16].

Pra, komuniteti me normat e tij shoqërore dhe besimin luan një rol të rëndësishëm në sjelljen e prindërve dhe aftësinë e tyre prindërore. Të ashtuquajturat "marrëdhënie shoqërore", të krijuara brenda komunitetit, lehtësojnë bashkëpunimin për përfitim reciprok, duke zvogëluar shkeljen e të drejtave të fëmijëve dhe duke krijuar një mjedis me përgjegjshmëri të lartë kolektive, ku banorët angazhohen bashkërisht për të ndihmuar njeri-tjetrin në mbrojtjen e fëmijëve të tyre[17]. Por mbrojtja e fëmijëve nga forma të ndryshme të dhunës, shfrytëzimit, trafikimit, abuzimit dhe të neglizhencës është një detyrë komplekse që kërkon një baraspeshë të kujdesshme të përgjegjësisë individuale me atë kolektive. Prandaj, promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe respektimi i tyre përqendrohen në krijimin e komuniteteve mbështetëse, bashkëpunuese dhe të hapura, me qëllim për të ndryshuar sjelljen e qëndrimet e prindërve dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës në komunitet dhe bashkëpunimin me institucionet për mbrojtjen e fëmijëve.

1.3 Modeli i ndërhyrjes së fondacionit "Terre des hommes" në komunitetin në nevojë



16 Barry, F (1994) A Neighbourhood-Based Approach: What is it? In **Protecting Children from Abuse and Neglect: Foundations for a New National Strategy**, edited by Gary Melton and Frank Barry, New York: Guilford Press, pp: 14-39;
17 Putnam, R (1995) Bowling Alone: America's Declining Social Capital, **Journal of Democracy** 6, pp: 65-78;

Modeli i ndërhyrjes i fondacionit "Terre des hommes" në komunitetin në nevojë bazohet në një qasje gjithëpërfshirëse që ndërthur ndërhyrjen e përqendruar te komuniteti, ndërhyrjen e bazuar te të drejtat e njeriut dhe ndërhyrjen për ngritjen e kapaciteteve të komunitetit.

- ***Ndërhyrja e përqendruar te komuniteti*** synon që të ndihmojë drejtpërdrejt komunitetin në nevojë për të parandaluar rreziqet e ndryshme që cënojnë mbrojtjen e fëmijëve, duke krijuar lidhje efektive me struktura mbështetëse bashkëkohore. Përforcimi i vetëvlerësimit të personave që kanë nevojë për mbrojtje, fuqizimi i tyre dhe rritja e bashkëpunimit me aktorë të tjerë, të angazhuar për mbrojtjen e fëmijëve, janë disa nga objektivat kryesore të kësaj ndërhyrjeje;

- ***Ndërhyrja e bazuar te të drejtat e njeriut*** përqendrohet njëkohësisht te procesi dhe rezultati, duke mbështetur njerëzit në nevojë, me qëllim për të kërkuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre. Duke harmonizuar parimin e pjesëmarrjes me atë të fuqizimit, si individë dhe si komunitet, me qëllim për të nxitur ndryshimin e sjelljeve dhe të qëndrimeve ndaj fenomeneve të ndryshme të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, kjo ndërhyrje sfidon deri diku anëtarët e komunitetit për të rishikuar dhe për të rivlerësuar sistemin e tyre të vlerave në lidhje me trajtimin e fëmijëve dhe i aftëson ata që të bëjnë ndryshimet e duhura, duke reflektuar në një mënyrë kritike. Një ndërhyrje e tillë bën që mbrojtja e fëmijëve dhe respektimi i të drejtave të tyre në komunitet të mos jenë diçka subjektive, që varet nga vullneti ose dëshira e mirë e anëtarëve të komunitetit për t'i mbrojtur ata, por diçka e bazuar në parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, në përgjithësi, dhe të të drejtave të fëmijëve, në veçanti;

- ***Ndërhyrja për rritjen e pjesëmarrjes së kapaciteteve të komunitetit*** duhet të përqendrohet te bashkëpunimi i ngushtë dhe i vazhdueshëm me komunitetin sipas vlerësimit të nevojave të tij, me qëllim: a) ndërgjegjësimin e tij për të drejtat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijëve; b) inkurajimin e tij për të hartuar plane ndërhyrjeje konkrete, me qëllim për të respektuar të drejtat e fëmijëve; c) përmirësimin e aftësive komunikuese dhe ndërmjetësuese; d) forcimin e bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm të komunitetit dhe të pushtetit lokal.

1.3.1 Pse u zgjodh ky model ndërhyrjeje?

Nga ***këndvështrimi i komunitetit në nevojë***, *ky model ndërhyrjeje mbështet procesin e ndërgjegjësimit, mobilizimit, fuqizimit dhe të pjesëmarrjes së tij në politikat dhe strategjitë e qeverisjes vendore e rajonale,* duke ndikuar në përmirësimin e marrëdhënieve mes grupeve/komuniteteve në nevojë (bartës të të drejtave) dhe vendimmarrësve (autoriteteve përgjegjëse) për mbrojtjen e fëmijëve, promovimin e të drejtave të tyre dhe përfshirjen shoqërore. Pra, në vend që të tjerët të ngrenë zërin e tyre lidhur me shkeljen e të drejtave të komunitetit në nevojë dhe të

fëmijëve të tij, ky model i inkurajon ata që të jenë aktorë aktivë në njohjen dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Nga ***këndvështrimi i drejtuesve të pushtetit vendor e rajonal***, *ky model ndërhyrjeje shërben si një instrument aktiv për të krijuar një qasje sa më të përshkallëzuar ndaj komunitetit,* duke e lehtësuar dhe duke i mundësuar komunitetit në nevojë që të përfitojë nga kuadri ekzistues ligjor dhe nga një sërë strategjish që janë në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe për përfshirjen shoqërore.



- ***Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*** *ndalon diskriminimin, për shkak të racës, përkatësisë etnike ose gjinisë;*
- ***Konventa kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare*** *në (Nenet 1, 3, 4 dhe 5) thekson garantimin e lirive themelore dhe të të drejtave të pakicave kombëtare pa asnjë lloj diskriminimi;*
- ***Strategjia kombëtare "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom"*** *(2003-2015) nënvizon marrjen e masave konkrete për përfshirjen dhe për integrimin e këtij komuniteti në jetën publike të vendit;*
- ***Plani Kombëtar i Veprimit për dekadën e përfshirjes së romëve*** *(2010-2015) synon që të përmirësojë statusin social-ekonomik dhe përfshirjen shoqërore të tyre, duke reduktuar pabarazinë në zhvillimin e këtij komuniteti dhe duke mundësuar qasjen te shërbimet përkatëse;*
- *Ligji 10437, datë 4.11.2010, "**Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës**" synon mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijëve në bashkëpunim me strukturat dhe autoritetet të ndryshme qendrore e vendore*

Mobilizimi dhe Fuqizimi i Komunitetit në Nevojë për Mbrojtjen e Fëmijëve

2

2.1 Vështrim i përgjithshëm

Mobilizimi i komunitetit është një proces i orientuar, bashkëbisedues dhe pjesëmarrës që ka të bëjë me informimin, ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve komunitetit, me qëllim që ata t'i kuptojnë më mirë të drejtat e tyre, në përgjithësi, dhe të drejtat e fëmijëve, në veçanti, dhe me qëllim që ta ngrenë bashkërisht zërin për mbrojtjen e fëmijëve me anë të një ndërhyrjeje të frytshme dhe të koordinuar. Si i tillë, ky proces i rëndësishëm që synon ngritjen e zërit kundër shkeljes së të drejtave të komunitetit në nevojë dhe të fëmijëve, përfshin tre elemente kryesorë:



2.2 Hapat e ndjekur në mobilizimin e komunitetit

Për të mobilizuar anëtarët e komunitetit në nevojë, ekipi i ndërmjetësve të fondacionit "Terre des hommes" i kushtoi një rëndësi të vazhdueshme si rritjes së përgjegjësisë kolektive për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre, ashtu edhe përmirësimit të sjelljeve dhe të qëndrimeve të anëtarëve të komunitetit ndaj fëmijëve, duke inkurajuar modele dhe praktika pozitive për parandalimin e formave të ndryshme të abuzimit me fëmijët.

2.2.1 Planifikimi i mobilizimit të komunitetit

Planifikimi i mobilizimit të komunitetit kalon në disa faza:



2.2.1.1 Profili i komunitetit dhe hyrja në komunitet

Njohja e profilit të komunitetit ndihmon për të kuptuar mundësitë e tij njerëzore dhe shoqërore, si dhe llojin e problemeve që ai ndesh në fushën e mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të fëmijëve. Aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet e individëve të komunitetit, nga njëra anë, si edhe natyra e marrëdhënieve, lidhjet mes njerëzve dhe niveli i besimit, nga ana tjetër, ndikojnë te shpejtësia dhe cilësia e reagimit të komunitetit ndaj fenomenit, si edhe te rezultati i ndërhyrjes së zgjedhur, për të zvogëluar pasojat e saj negative. Për të arritur këtë qëllim, një rëndësi të veçantë ka "hyrja në komunitet" që ndikon jo vetëm në vendosjen e raporteve pozitive me anëtarët e tij, por edhe në nivelin e tyre të pjesëmarrjes në planifikimin e ndërhyrjes dhe zbatimin e saj. Për këtë qëllim, ekipi i ndërmjetësve të të fondacionit "Terre des hommes" ndërmori dy hapa dhe përdori instrumentet përkatës (*Shtojca 1*):

Hapi 1 → *Mbledhja e informacionit rreth komunitetit* → *a) Informacion nga bashkia/ komuna; b) Informacion nga OJF-të; c) Vëzhgime në komunitet;*

Hapi 2 → *Hyrja në komunitet* → *a) Takim me drejtuesit e komunitetit; b) Perceptimi i komunitetit për komunitetin;*

Perceptimi i komunitetit nga banorët e tij, fshati Novoselë, komuna Novoselë

- ***1600*** *banorë romë (rreth 285 familje);*
- ***855*** *fëmijë (0-18 vjeç);*
- ***197*** *fëmijë romë shkojnë në shkollë;*
- ***12*** *fëmijë romë shkojnë në kopshte;*
- ***9*** *fëmijë romë marrin pagesë paaftësie;*
- ***18*** *familje rome merren me shitje rrobash të përdorura;*
- ***108*** *anëtarë të komunitetit rom janë punëkërkues;*
- ***11*** *familje rome marrin ndihmë ekonomike;*

Të dhëna të mbledhura për komunitetin rom, lagjia NISH-tulla, qyteti Durrës

Çfarë duhet patur parasysh, kur "hyjmë në komunitet"?

a.objektiva të qartë;
b.informimi i anëtarëve të komunitetit mbi qëllimin e mbledhjes së informacionit;
c.inkurajimi i komunitetit për të identifikuar burimet dhe kapacitetet e tij;
d.konteksti social-ekonomik, dinamika e problemeve, diversiteti kulturor;
e.njohja me pjesën "rezistente"të komunitetit dhe konflikti i grupit;

Përparësitë e "hyrjes në komunitet":

a. rritje e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi problematikat e mbrojtjes së fëmijëve;
b. vendosja e raporteve të besimit dhe bashkëpunimit pozitiv;
c. përdorimi i mirë i burimeve dhe i kapaciteteve të komunitetit për interesin më të lartë të fëmijës;
d. pjesëmarrje, konsultime dhe monitorim i vazhduar;

2.2.1.2 Vendosja e kontakteve me komunitetin

Vendosja e kontakteve me komunitetin dhe zgjedhja e njerëzve të duhur është një investim i madh që kërkon kohë, energji dhe besim, pasi të rriturit kanë nevoja, kërkesa dhe përgjegjësi që duhen pasur parasysh, kur ata të shërbejnë si "katalizatorë" të ndryshimit të komunitetit. Ndonëse janë të pavarur dhe drejtues të vetvetes, edhe pse kanë mendimet e opinionet e tyre për të mbrojtur dhe për të respektuar të drejtat e fëmijëve, ata ndeshen vazhdimisht me sfidën e vendosjes së një ekuilibri mes kohës që u duhet për të përmbushur nevojat individuale e familjare, dhe kohës që u duhet për t'iu përkushtuar përgjegjësive kolektive. Prandaj, zgjedhja e njerëzve të përshtatshëm dhe aktivë që gëzojnë respektin e komunitetit dhe që kanë ndikim të dukshëm te ai, është thelbësore për të komunikuar mesazhet e duhur te pjesa tjetër e komunitetit. Duke e ditur se çdo komunitet ka aktivistët dhe drejtuesit e

tij joformalë, kontakti i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm me ta, duke zbatuar rregullat dhe normat e komunitetit, ndihmon në vendosjen e një raporti bashkëpunues dhe mirëkuptues në dobi të interesave të komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve. Ndonëse informacioni i mbledhur dhe i shkëmbyer në këtë fazë mund të mos jetë shumë i ri, sjelljet dhe qëndrimet e komunitetit që duhen ndryshuar ose duhen përmirësuar, shërbejnë për të vlerësuar në mënyrë kritike pikëpamjet dhe mendimet e tyre në lidhje me mobilizimin e komunitetit, me qëllim për t'iu përgjigjur pozitivisht çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve.

Vështirësitë e hasura gjatë vendosjes së kontakteve në komunitet:

a.problematika të shumta; vështirësi në formulimin e prioriteteve;
b.nivel i ulët arsimor, probleme me mentalitetin;
c.besimi i pakët te ndryshimet;
d.diskriminimi gjinor;
e.motivim i ulët për të ndihmuar komunitetin;
f. vetëvlerësim i ulët;

Metodat e përdorura për t'i përballuar ato:

a. mbështetja te pikat e forta të komunitetit dhe përforcimi i tyre;
b. dëgjimi aktiv dhe inkurajimi i komunitetit për të shprehur shqetësimet e tij;
c. komunikimi i shpeshtë, i hapur, i qartë;
d. ndjeshmëria ndaj nevojave, kulturës, traditës;
e. reflektim kritik, mendim krijues;

Ndërmjetësi i fondacionit "Terre des hommes" në Pogradec gjatë një takimi me aktivistë të komunitetit rom, lagjia nr.5, Pogradec

2.2.1.3 Krijimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit (GKK)

Grupi i Këshillimit të Komunitetit (GKK) është një grup i krijuar mbi baza vullnetare, i përbërë nga disa anëtarë të komunitetit (zakonisht 3-8 veta) të grupmoshave dhe të gjinive të ndryshme, të cilët janë të përkushtuar dhe luajnë një rol aktiv në mbrojtjen e fëmijëve dhe në respektimin e të drejtave të tyre në komunitet. Duke shërbyer si pika kontakti brenda komunitetit, anëtarët e këtij grupi përbëjnë një urë lidhëse mes komunitetit në nevojë dhe strukturave të tjera lokale publike dhe jopublike. Pavarësisht nga karakteri vullnetar i kontributit të tyre, anëtarët e këtij grupi shërbejnë si bërthama të komunitetit, me qëllim për të identifikuar fëmijët në nevojë, për të mobilizuar anëtarët e komunitetit dhe për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve nga forma të ndryshme të shkeljes së të drejtave të tyre dhe referimin e rasteve te identifikura në rrezik te strukturat përkatëse.

Karakteristikat e anëtarëve të GKK-së:

a. kanë aftësi të mira komunikuese dhe janë të hapur për bashkëpunim;
b. kanë shpirtin e iniciativës dhe besojnë te ndryshimet;
c. njohin mirë komunitetin dhe mbështeten te pikat e tij të forta;
d. respektojnë ndryshimet kulturore, traditën dhe normat e komunitetit;
e. njohin etikën dhe ruajnë konfidencialitetin;
f. kanë njohuri mbi të drejtat e fëmijëve;

Grupi i Këshillimit të Komunitetit, fshati Levan, komuna Levan, rrethi Fier

Latif Kazanxhiu, GKK fshati Baltëz, komuna Dërmenas, rrethi Fier

Pse vendosa të jem anëtar i GKK-së në fshatin Baltëz:

Përfshirja ime në këtë grup nuk ka qenë diçka e rastit, por rrjedhojë e nevojës dhe e domosdoshmërisë që kishte komuniteti ynë për krijimin e një grupi të tillë që do ta mobilizonte atë në drejtim të ndërgjegjësimit dhe të referimit të problemeve të tij. Duke qenë rom dhe pjesë e këtij komuniteti në nevojë, gjithmonë kam menduar se askush më mirë sesa ne nuk i di hallet tona dhe vetëm ne mund ta ngrejmë zërin së bashku, për të bërë të mundur përmirësimin e jetës sonë dhe atë të fëmijëve tanë. Përvoja ime ka treguar se zëri i një grupi dëgjohet më fort sesa zëri i një individi të veçuar.

2.2.1.4 Identifikimi me pjesëmarrje i nevojave të komunitetit

Puna e përbashkët me komunitetin dhe Grupin e Këshillimit të Komunitetit për identifikimin e nevojave të tij, konsultimet e vazhdueshme me ta, me qëllim për të caktuar prioritetet, dhe komunikimi i hapur mbi mënyrën e referimit të tyre te strukturat përkatëse ndikojnë pozitivisht si në rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit, ashtu edhe në shtimin e besimit për ndryshimet e nevojshme. Të qartësuar për përfitimet e këtij procesi gjithëpërfshirës, ata ndihmojnë natyrshëm për ta mbështetur atë, duke u bërë pjesë përbërëse e tij. Identifikimi i drejtpërdrejtë i nevojave të komunitetit u realizua nga disa grupe të caktuara[18] në gjashtë zona të projektit, përkatësisht në Elbasan (zona Rrapishtë), Durrës (zona NISH-tulla), fshatrat Baltëz (komuna Dërmenas), Levan (komuna Levan), Rom (komuna Qendër) dhe Novoselë (komuna Novoselë), që u mundësuan nga ndërmjetësit e fondacionit "Terre des hommes" në komunitet në bashkëpunim me anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit. Grupet në fjalë përcaktuan se anëtarët e komunitetit kanë jo vetëm informacione të pamjaftueshme për

18 Gjithsej 120 anëtarë komuniteti morën pjesë në 12 grupet.

institutionet që ndodhen në komunitetin e tyre dhe për shërbimet që ata ofrojnë, por edhe informacione të pamjaftueshme për të drejtat e tyre, me qëllim për të përfituar nga shërbimet e tyre:

Nr	Pyetje	Përgjigje në %
1	*A jeni në dijeni të institucioneve që ofrojnë shërbime për komunitetin tuaj?*	
	Shkolla	48.3
	Kopshte	23.3
	Çerdhe	14.2
	Zyra e Ndihmës Ekonomike dhe e Përkujdesit Shoqëror	25.8
	Zyra e Gjendjes Civile	40.8
	Komuna/bashkia	36.7
	Zyra e Sigurimeve Shoqërore	18.3
2	*A keni dijeni për të drejtat tuaja për të përfituar nga shërbimet e ofruara prej tyre?*	
	Mirë	35
	Shumë mirë	10.8
3	*Cilët janë disa nga shkaqet që ju nuk keni informacionin e duhur për të drejtat tuaja për të përfituar nga shërbimet e ofruara prej tyre*	
	Mungesë informacioni	46.7
	Mungesë sqarimi	42.5
	Diskriminim	35.8
	Vështirësi për të biseduar	22.5


Problemet e Komunitetit:
1- Kequshqyerja ne pamundesi te mjaftueshme te ekonomisë.
2- Problemi i strehimit.
3- Papunesia
4- Shkollim jo i mjaftushem.


b) Problemet e komunitetit jani: nga mi te
nderyshmet.
- Ekonomia e tyre eshte ren nivelin normal.
- Nuk punohet sa duhet për arsimimin e
tyre.
- Nuk perfaqesohen ne pushtet si gjithë
minoritetet e tjera.
- Duhet punuar me shumë për integrimin e
tyre me pjesën tjetër te komunitetit.
- Te ndergjegjesohen për planifikimin familjar.
Ruajnë me fanatizëm traditat tye

Identifikimi i drejtpërdrejtë i nevojave, komuniteti rom, lagjia nr.5, Pogradec

2.3 Mbështetja dhe fuqizimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit

Fuqizimi i komunitetit në nevojë synon që të ndryshojë gjendjen e tij social-ekonomike, duke kaluar nga një situatë më pak e kontrolluar e gjendjes në një situatë me më shumë kontroll të saj. E thënë ndryshe, fuqizimi i komunitetit në nevojë është një *proces* (që përqendrohet te mënyra se si fuqizohet komuniteti) dhe një *rezultat* (që përqendrohet te ndryshimet që ai sjell në komunitet).

Por ndryshimi i sjelljes dhe i qëndrimeve të komunitetit ndaj fëmijëve në nevojë dhe mbrojtjes së tyre nuk ndodh me një aktivitet të vetëm, por është rezultat i një procesi të gjatë, suksesi i të cilit varet nga shtimi i numrit të anëtarëve të komunitetit që e përkrahin ndryshimin dhe që përpiqen ta përhapin atë sa më shumë që të jetë e mundur në radhët e tij. Grupi i Këshillimit të Komunitetit është një grup i krijuar nga banorët e komunitetit dhe ai synon që t'i vijë në ndihmë komunitetit, ndërsa rritja e kapaciteteve të tij, fuqizimi dhe shtimi i rradhëve me anëtarë të rinj do ta ndihmonte atë që të përpiqet më shumë për të kërkuar respektimin e të drejtave të komunitetit, në përgjithësi, dhe të të drejtave të fëmijëve, në veçanti, duke ndërmarrë veprime konkrete për të realizuar përgjegjësitë e tij para komunitetit. Fuqizimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit kalon në pesë faza: a) informimi i komunitetit; b) takime/konsultime të rregullta me anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit; c) ngritje kapaciteti; d) mbështetja me aktivitete; e) monitorimi.



2.3.1 Informimi i komunitetit mbi rolin e Grupit të Këshillimit të Komunitetit

Angazhimi i komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve do të thotë se anëtarët e tij, ndonëse janë individë unikë, ata e mbështesin fuqimisht përgjegjësinë e tyre kolektive për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për fëmijët dhe familjet e tyre. Pra, kur banorët e komunitetit e kuptojnë se kanë një grup aktiv, i cili i mbështet kërkesat e tyre dhe mundohet që t'u japë atyre zgjidhje institucionale, duke bashkëpunuar me struktura të tjera lokale, atëherë ndikimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit është i madh, me qëllim për të ndryshuar praktikat e komunitetit dhe për të vendosur një sistem mbrojtjeje që ndihmon të referohen shkaqet e ndryshme të shkeljes së të drejtave të fëmijëve. Për të arritur një nivel të tillë ndërgjegjësimi të komunitetit mbi rolin e këtij grupi, anëtarët e tij kanë përdorur disa mënyra si: biseda të rastit (individuale ose në grup), vizita në familje dhe takime të rregullta e të planifikuara me komunitetin. Duke qenë se secili anëtar i Grupit të Këshillimit të Komunitetit vjen nga një lagje, rrugë, rrugicë ose zonë e veçantë e fshatit (për zonat rurale) të komunitetit, objektivi i tyre kryesor ka qenë pikërisht informimi i banorëve të këtyre "komuniteteve të vogla", ku ata banojnë, dhe, më pas, informimi i të gjithë komunitetit. Metodologjia e përshkallëzuar paraqitet si më poshtë:



Takim midis anëtarëve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit, lagjia Rrapishtë, Elbasan

Përgjegjësitë e Grupit të Këshillimit të Komunitetit:

a) identifikimi i zonave më problematike të komunitetit;
b) identifikimi i fëmijëve në rrezik dhe referimi i tyre në strukturat lokale;
c) informimi i familjeve mbi shërbimet e ofruara në komunitet dhe referimi i tyre në strukturat lokale;
d)bashkëpunimi me familjet dhe strukturat lokale në menaxhimin e rastit përkatës;
e) ndërgjegjësimi i komunitetit mbi çështje të të drejtave të fëmijëve;
f) avokatësi për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;

Vizitë në familje, anëtarë të Grupit të Këshillimit të Komunitetit, fshati Rom, komuna Qendër, rrethi Fier

2.3.2 Takime/konsultime me anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit

Përveç bisedave dhe takimeve të përditshme në komunitet, anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit kanë kryer takime të rregullta të lehtësuara dhe strukturuara nga ndërmjetësit e fondacionit "Terre des hommes" në komunitet. Duke ditur se çdo anëtar i grupit ka diçka të vlefshme për të diskutuar ose për të ndarë me të tjerët, ndërmjetësi i fondacionit "Terre des hommes" në komunitet i ndihmon ata që të shprehin mendimet e tyre, të kuptojnë situatat e ndryshme dhe të mësojnë nga njeri-tjetri për të vepruar bashkërisht. Këta takime kanë qenë të planifikuara më parë sipas një programi të qartë, të bazuar në informacionin e përditësuar të mbledhur nga anëtarët e këtij grupi mbi nevojat dhe problematikat që ka komuniteti për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre, nga njëra anë, dhe nevojës që ata kanë për ngritje kapacitetesh dhe përmirësim të njohurive të tyre për mbrojtjen e fëmijëve, nga ana tjetër. Këta takime janë të orientuar drejt arritjes së rezultateve ose ndërmarrjes së hapave konkretë, duke u bazuar në ndërveprimin mes anëtarëve dhe punës së tyre të përbashkët për të nxitur iniciativa konkrete për të zgjidhur probleme komplekse.

Anëtarë të Grupit të Këshillimit të Komunitetit, lagjia Rrapishtë, Elbasan, në takimin e lehtësuar nga ndërmjetësja e e fondacionit "Terre des hommes" në komunitet

Çfarë duhet patur parasysh për të patur takime frytdhënëse:

a. Anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit duhet të jenë të informuar më parë për takimin;
b. Anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit duhet të jenë të hapur që të diskutojnë problemet e ngritura në komunitet nga takimet e kryera me anëtarë të komunitetit;
c. Anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komuniteti duhet të jenë bashkëpunues për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme;

2.3.3 Ngritja e kapaciteteve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit

Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit dhe të anëtarëve të tjerë të komunitetit është kryer me anë të trajnimeve periodike, temat e të cilëve janë përzgjedhur prej tyre, me qëllim që t'i shërbejnë rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit mbi përgjegjësinë e tij kolektive për parandalimin e formave të ndryshme të shkeljes së të drejtave të fëmijëve dhe për mbrojtjen e tyre. Anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit janë inkurajuar që ata të jenë aktivë në këtë proces, duke u përfshirë në identifikimin e kapaciteteve që ekzistojnë brenda komunitetit për trajnimin e tyre, vendin dhe orarin, kur do të kryhet trajnimi, si edhe në lajmërimin e pjesëmarrësve nga komuniteti për trajnimin e radhës. Kjo i ka ndihmuar ata që të bëhen pjesë e monitorimit të procesit të ndërgjegjësimit të komunitetit dhe të përpjekjeve që ai bën për të ndryshuar ose për të përmirësuar sistemin e vlerave e të sjelljeve dhe qëndrimet ndaj mbrojtjes së fëmijëve dhe respektimit të të drejtave të tyre.

Trajnim i anëtarëve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit dhe të anëtarëve të komunitetit, lagjia Shkozet, Durrës

Çfarë duhet pasur parasysh gjatë trajnimit:

a. Pjesëmarrësit duhet të jenë në dijeni të temës së trajnimit që do të zhvillohet;
b. Pjesëmarrësit duhet të jenë të grupmoshave dhe gjinive të ndryshme, duke këmbëngulur për përfaqësim të barabartë gjinor;
c. Mesazhet e trajnimit duhet të jenë të qartë, të formuluar thjesht dhe të kuptueshëm për pjesëmarrësit;
d. Pjesëmarrësit duhen inkurajuar që të sjellin përvoja ose shembuj nga jeta e tyre dhe problemet që ndeshin;
e. Sugjerime për ndryshimin e situatës;





Mendime të pjesëmarrësve në trajnim për njohuritë e marra gjatë trajnimeve, lagjia NISH-Tulla, Durrës

Rezultate të arritura nga trajnimet:

a) Rritje e numrit të pjesëmarrësve të ndërgjegjësuar;
b) Përmirësim i njohurive mbi tema të ndryshme të zhvillimit dhe mbrojtjes së fëmijëve;
c) Rritje e numrit të anëtarëve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit;
d) Rritje e numrit të rasteve të fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje;

2.3.4 Mbështetja e aktiviteteve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit

Identifikimi i fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje ose i praktikave diskriminuese në komunitet ose të prindërve që shfaqin qëndrime abuzive dhe sjellje neglizhuese ndaj fëmijëve të tyre, nuk është i mjaftueshëm për sa kohë që atyre nuk u ofrohet ndonjë mundësi për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre prindërore në drejtim të fëmijëve. Prandaj, trajnimi i anëtarëve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit nuk ka si qëllim në vetvete ngritjen e kapaciteteve të një numri të caktuar të anëtarëve të tij, por përhapjen e informacioneve dhe të njohurive të marra edhe te anëtarët e tjerë të komunitetit, në përgjithësi, dhe te pjesa që është më në rrezik për t'u përfshirë në sjellje dhe praktika abuzive ndaj fëmijëve, ne veçanti. Krijimi i një mjedisi të ndërgjegjësuar dhe bashkëpunues që përpiqet të inkurajojë ato norma dhe vlera shoqërore të komunitetit që ndikojnë pozitivisht në ndërveprimet personale mes anëtarëve të tij, në marrëdhëniet prind-fëmijë dhe në përgjegjësitë individuale e kolektive për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre, nxit jo vetëm zhvillimin pozitiv e të shëndetshëm të fëmijëve, por edhe forcon burimet formale dhe informale të komunitetit. Por ndërgjegjësimi i të rriturve për rolin dhe përgjegjësinë e tyre për mbrojtjen e fëmijëve nuk do të ishte i plotë, nëse edhe vetë fëmijët nuk ndërgjegjësohen për të drejtat që ata kanë. Për këtë qëllim, aktivitetet ndërgjegjësuese, të kryera nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit, janë përqendruar si te të rriturit, ashtu edhe te fëmijët.

2.3.4.1 Aktivitete ndërgjegjësuese me të rriturit

Aktivitetet parandaluese me të rriturit synojnë që të zhvillojnë te ata dëshirën e mirë për të ndihmuar dhe për të "investuar" në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve dhe të krijimit të një komuniteti të sigurt për ta, duke i informuar mbi shkaqet dhe pasojat e shkeljes së të drejtave të tyre, duke u dhënë informacionet e duhura mbi llojet e ndryshme të shërbimeve që ofrohen në komunitet dhe duke i inkurajuar ata që të jenë vigjilentë dhe të ngrenë zërin e tyre së bashku ndaj çdo rasti të abuzimit me fëmijët ose çdo lloj shenje pasigurie për fëmijët që ata evidentojnë në komunitet. Aktivitetet ndërgjegjësuese janë të suksesshme, kur ato koordinojnë dhe harmonizojnë tre elemente kryesorë: a) planifikimin e aktivitetit; b) organizimin e aktivitetit; c) monitorimin e aktivitetit. Mbledhja e vazhdueshme e mendimeve dhe e sugjerimeve të anëtarëve të komunitetit mbi aktivitetet e kryera nxit pjesëmarrjen më të madhe të tyre dhe forcon ndërveprimin frytdhënës.

Vështirësitë e hasura në organizimin e aktiviteteve me të rriturit:

a. Pjesëmarrje jo e kënaqshme nga grupet më në nevojë ose nga pjesa më rezistente;
b. Pjesëmarrje e ulët e grave në aktivitete, për shkak të angazhimit të tyre në përkujdesjen ndaj fëmijëve;
c. Mungesa e qendrave komunitare për organizimin e aktiviteteve;
d. Vështirësi në caktimin paraprak të orarit të aktiviteteve, për shkak të angazhimeve të tjera të anëtarëve të komunitetit;

Masat e marra për zvogëlimin e tyre:

a. Ndërmjetësimi për të marrë pjesë në aktivitete një përfaqësi e tyre, e cila më pas do të informojë edhe anëtarët e tjerë në bashkëpunim me Grupin e Këshillimit të Komunitetit;
b. Gratë u lejuan të merrnin pjesë në aktivitete bashkë me vajzat dhe fëmijët e vegjël;
c. Aktivitetet u zhvilluan, sipas rastit, në mjediset e komunës, në oborrin e shtëpive të banorëve ose në lokalin e lagjes/fshatit, të marrë me qira;
d. Orari i aktiviteteve ndryshoi sipas mundësive dhe kërkesave të banorëve, duke marrë miratimin e tyre;

Ativitet ndërgjegjësues i organizuar nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit, lagjia Rrapishtë, qyteti Elbasan

Mesazhet e dhëna nga anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit gjatë aktivitetit me temë "Prindërimi pozitiv dhe disiplinimi pozitiv":

Disiplinë pozitive do të thotë:
a. Përdorni forma jo të dhunshme ndëshkimi; mos përdorni dhunë fizike ose psikologjike ndaj fëmijëve;
b. Mos impononi autoritetin tuaj te fëmijët;
c. Mos gjykoni fëmijët, por veprimet ose sjelljet e tyre;
d. Ofrojuni fëmijëve sjellje të tjera pozitive;
e. Përfshijini sa më shumë fëmijët në biseda, duke i informuar ata për pasojat e sjelljeve negative ose problematike;
f. Reagoni në mënyrë të arsyshme në varësi të moshës së fëmijëve;

Reflektime të pjesëmarrësve rreth aktivitetit:

- *"Është vështirë të jesh prind i mirë sot, pasi fëmijët tanë po rriten ndryshe nga neve. Shumë gjëra kanë ndryshuar dhe ne duhet të ndryshojmë mënyrat tona të trajtimit të fëmijëve";*
- *"Ngaqë nuk kemi shkollë sa duhet, mendojmë se vetëm duke bërtitur, do të na binden fëmijët";*
- *"Prindi nuk ia do të keqen fëmijës së tij, por zgjedh rrugën e gabuar të dhunës, për t'ia arritur qëllimit";*
- *"Me të bërtitur nuk zgjidhen punët. Duhet durim e fjalë e ëmbël. Dhuna sjell dhunë";*

2.3.4.2 Aktivitete me fëmijët

Aktivitetet e organizuara me fëmijët kanë patur qëllime të dyfishta: a) ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre në jetën e përditshme; b) përmirësimin e aftësive të tyre për të identifikuar fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje ose situatat abuzive në komunitet. Duke i ndihmuar fëmijët që të zhvillojnë faktorët e tyre mbrojtës (në rastet, kur nuk i kanë) dhe të forcojnë faktorët e tyre mbrojtës (në rastet, kur ata ekzistojnë), këto aktivitete kanë ndikuar në zvogëlimin e faktorëve të rrezikut që shoqërohen me pasoja negative për shoqërizimin, ndërveprimin shoqëror dhe zhvillimin e shëndetshëm e të sigurt të fëmijëve. Një aktivitet domethënës për fëmijët është kampi veror.

Kampi veror, fshati Levan, komuna Levan, Fier

Kampi veror zgjat rreth një muaj dhe është një aktivitet që ofron një mjedis miqësor e gazmor që ndërthur elementë të ndryshëm edukativë, sportivë, ndërgjegjësues, argëtues, mësimorë, kulturorë dhe artistikë. Fëmijët janë protagonistët kryesorë të aktiviteteve ditore, duke marrë pjesë në procesin e planifikimit të tyre dhe duke dhënë sugjerime konkrete për mënyrën e organizimit të tyre. Anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit bashkëpunojnë ngushtësisht me ta, me qëllim që ata të ndihen të përfshirë dhe aftësitë e tyre ndërvepruese, komunikuese e shoqërore të përmirësohen. Por kampi veror shërben edhe për të identifikuar fëmijë të rinj që kanë nevojë për mbrojtje ose që janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme, për t'i referuar ata në strukturat përkatëse.

Mendime nga fëmijët

***Historia e R.M nga lagjia Rrapishtë në qytetin Elbasan**:*

Në aktivitetin e kryer me temë "Ambienti, ku unë jetoj", djali ngurron të vizatojë dhe nuk jep shpiegime. Më pas, ai i tregon mësueses së kampit "Unë nuk mund të vizatoj mësuese, sepse nuk kam shtëpi. Unë dhe familja ime jetojmë në barakë dhe mua nuk më pëlqen baraka, ku ne jetojmë". Në aktivitetin me temë "Ku dua unë të jetoj" fëmijëve iu kërkua të vizatonin se çfarë do të donin të kishin për t'u ndjerë të sigurt në lagjen e tyre dhe gjëja e pare që djali R.M vizaton, është një shtëpi me orendi (krevate dhe televizor). Ai shprehet se ndjehet i frikësuar, kur fle natën në barakë, ndërsa në kamp ai ndihet mirë dhe i sigurt, sepse "...mësuesit flasin me zë të ulët dhe nuk na bërtasin", "unë nuk di të shkruaj mirë, por çdo ditë vizatoj fytyrën time... po kënaqem shumë".

2.3.4.3 Monitorimi i aktiviteteve

Monitorimi i aktiviteteve nga përfituesit e tij të drejtpërdrejtë (anëtarë komuniteti, prindër dhe fëmijë) është një proces reflektimi për Grupin e Këshillimit të Komunitetit, me qëllim për të kuptuar mangësitë e evidentuara në arritjen e rezultateve të dëshiruara, për të vlerësuar se sa kanë ndikuar ato në përmbushjen e interesave e të nevojave të paplotësuara të pjesëmarrësve dhe për të diskutuar përgjegjësitë që duhen marrë për ta përshtatur në kohë ndërhyrjen e duhur. Përfshirja e tyre në monitorim është e domosdoshme për të kuptuar pikat e dobëta të vlerësimit me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe se ku duhen përmirësuar ato. Në të kundërt, objektivat e aktiviteteve nuk do ta arrijnë qëllimin, për të cilin ato organizohen (*Shtojca 2*).

Promovimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit

3

Puna e Grupit të Këshillimit të Komunitetit (GKK) e përmbush misionin, për të cilin ky grup është krijuar, kur ai u shërben jo vetëm komunitetit në nevojë, por edhe strukturave të ndryshme të angazhuara për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal, rajonal dhe qendror, si edhe institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Kjo arrihet, duke i informuar ata mbi punën e tij dhe rezultatet konkrete të arritura me prindërit, familjet, fëmijët dhe komunitetin, duke iu ofruar atyre ndihmë e mbështetje konkrete, duke iu shpjeguar vlerën e kësaj pune, me qëllim për të arritur qëllimin e përbashkët të mbrojtjes së fëmijëve, dhe duke forcuar rrjetin e bashkëpunimit mes anëtarëve të Grupeve të Këshillimit të Komunitetit të zonave/qyteteve të ndryshme.



3.1 Fletëpalosje me aktivitetet e kryera nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit

Praktikat e ndryshme abuzive ndaj fëmijëve nuk luftohen me heshtje ose duke e shpërfillur ekzistencën e tyre në komunitet, por duke i identifikuar ato dhe duke e informuar komunitetin për pasojat e tyre në zhvillimin psikologjik, emocional, shoqëror dhe edukativ të fëmijëve. Meqenëse format e ndryshme të abuzimit me fëmijët nuk janë një problem i izoluar i komunitetit, por kanë pasoja edhe te fëmijët e tjerë të tij, atëherë, në fletëpalosjet e hartuara me nismën e Grupit të Këshillimit të Komunitetit pasqyrohen aktivitete me tematika të ndryshme që shqetësojnë mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve në komunitet. Ato shërbejnë si një mjet i rëndësishëm komunikimi për pjesën tjetër të komunitetit që nuk ka pasur mundësi të marrë pjesë në aktivitetet, me qëllim për të përmirësuar njohuritë e tyre mbi të drejtat e fëmijëve dhe respektimin e tyre, për të përçuar mesazhet e duhura, për të pasur një komunitet përgjegjës, bashkëpunues dhe jotolerant ndaj çdo forme të abuzimit ose të neglizhencës së fëmijëve, për t'i përmirësuar aftësitë e tyre dhe për të zhvilluar marrëdhënie të shëndetshme prind-fëmijë dhe familje-komunitet.

Të gjithë të ndihmojmë në shkollimin e fëmijëve tanë!

Roli i komunitetit në edukimin dhe shkollimin e fëmijëve

Komuniteti Rrom i lagjes Rrapishtë të qytetit Elbasan tregon një interesim të vazhduar për edukimin dhe integrimin e fëmijëve të tij në shkollat e këtij qyteti. Me iniciativën e tij dhe në bashkëpunim me anëtarët e Grupit të Këshillimit në Komunitet u organizua një aktivitet informues me temë "Edukimi i fëmijëve - përparësia jonë". Ky aktivitet kishte si qëllim kryesor: a) informimin e prindërve mbi rëndësinë e shkollimit të fëmijëve dhe të drejtat e fëmijëve për edukim e shkollim, b) ndërgjegjësimin e prindërve mbi rëndësinë e bashkëpunimit të tyre me shkollën dhe komunitetin për të ulur nivelin e braktisjes së shkollës. I zhvilluar në formën e një bashkëbisedimi të ngrohtë e miqësor midis pjesëmarrësve, duke sjellë shembuj konkretë nga jeta e tyre, anëtarët e Grupit të Këshillimit në Komunitet që drejtonin këtë aktivitet bënë thirrje të vazhdueshme mbi rolin që luan familja në edukimin e fëmijës, rëndësinë e shkollimit të fëmijëve si e drejta e tyre themelore dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit familje-shkollë në edukimin qytetar dhe arsimor të fëmijëve. Në përgjithësi, pjesëmarrësit në këtë aktivitet e vlerësuan atë pozitivisht, por nga ana tjetër theksuan edhe disa vështirësi që ndeshnin për shkollimin e fëmijëve të tyre të cilat ishin të lidhura kryesisht me kushtet e tyre të vështira social-ekonomike. Ky aktivitet informues në komunitetin Rrom të lagjes Rrapishtë të qytetit Elbasan u pasua edhe me aktivitete të tjera informuese në grupe më të vogla pjesëmarrësish dhe me vizita në familjet që kishin fëmijë në moshë shkolle. Si rezultat, 31 fëmijë Rrom të këtij komuniteti u referuan për herë të parë nga anëtarët e Grupit të Këshillimit në Komunitet në shkollat "Hamit Mullisi" dhe "Sul Domi", ndërsa 15 fëmijë të tjerë u referuan tek Fondacioni "Ndihmë për Fëmijët" për të marrë shërbime të ndryshme.

Fletëpalosje e Grupit të Këshillimit të Komunitetit (Rrapishtë), Elbasan

3.2 Tavolina të rrumbullakta të Grupit të Këshillimit të Komunitetit me përfaqësues të pushtetit vendor

Që fëmijët ta gëzojnë fëmijërinë e tyre, të rriten të shëndetshëm, të sigurt dhe të mbrojtur në komunitetin e tyre, duhen jo vetëm ndryshimi i kulturës dhe i praktikave të marrëdhënieve prind-fëmijë në familje dhe komunitet, por edhe përmirësimi i marrëdhënieve të komunitetit me pushtetin vendor, i cili është përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve në territorin administrativ të tij[19]. Meqenëse politikat e pushtetit vendor për mbrojtjen e fëmijëve lidhen drejtpërdrejt me interesat e tyre dhe të komunitetit, ku ata jetojnë, në përgjithësi, dhe të grupeve të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje, në veçanti, përfshirja e tyre në vendimmarrje dhe dëgjimi i zërit të tyre se cilat shërbime duhen shtuar/përmirësuar ose konsideruar si më të nevojshme, është pjesë e rëndësishme e qeverisjes së mirë. Në këtë drejtim, Grupi i Këshillimit të Komunitetit, i trajnuar dhe i informuar për problemet që ka komuniteti për mbrojtjen e fëmijëve dhe sigurinë e tyre, nuk është një strukturë paralele e pushtetit vendor në komunitet, por një urë lidhëse, një instrument ndihmues dhe bashkëpunues në dobi të interesit të komunitetit për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për mbrojtjen e fëmijëve.

19 Ligji 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"

Tavolinë e rrumbullakët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit me përfaqësues të pushtetit vendor, NISH-Tulla, Durrës

Gjatë tavolinës së rrumbullakët me përfaqësues të pushtetit vendor në Durrës u ngrit problemi i mungesës së librezave shëndetësore për fëmijët romë dhe anëtarët e rritur të këtij komuniteti. Në takim u sqarua se personat mbi 18 vjeç që janë të papunë, duhet të regjistrohen në Zyrën e Punës si punëkërkues, të marrin një vërtetim si të regjistruar në këtë zyrë dhe më pas të pajisen me librezë shëndetësore. Gjithashtu u sqarua se nxënësit e shkollave, personat që kryejnë shërbimin ushtarak ose studentët mund ta marrin librezën shëndetësore pa qenë nevoja që të regjistrohen si punëkërkues.

Rekomandime nga takimi

- *Nevoja e takimeve më të shpeshta mes anëtarëve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit dhe përfaqësuesve të pushtetit vendor;*
- *Bashkëpunim më i ngushtë me ndërlidhësit e komunitetit që janë punonjës të pushtetit vendor;*
- *Ndjeshmëri më e lartë ndaj problematikave të komunitetit rom;*
- *Përfshirja e Grupit të Këshillimit të Komunitetit në hartimin e planeve të përbashkëta të veprimit me pushtetin vendor në dobi të komunitetit rom;*

Rezulati

- *30 fëmijë të komunitetit rom në NISH-Tulla, Durrës, u pajisën me libreza shëndetësore;*
- *70 anëtarë të komunitetit rom u pajisën me libreza shëndetësore;*
- *Rritje e bashkëpunimit mes Drejtorisë së Shëndetit Publik dhe Grupit të Këshillimit të Komunitetit;*

3.3 Pjesëmarrja e Grupit të Këshillimit të Komunitetit në nivel rajonal

Qarku, si njësi e qeverisjes vendore, ka si qëllim zhvillimin dhe zbatimin e politikave në nivel rajonal, të cilat duhet të jenë të harmonizuara me politikat dhe strategjitë në nivel qendror[20]. Sektori i shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, i ngritur pranë Këshillit të Qarkut, përgatit hartën e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në nivel rajonal, sipas të dhënave të mbledhura nga njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna), dhe mbështet shërbimet e përkujdesjes

20 Ligji 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

shoqërore të specializuara për grupet në nevojë, si fëmijët, gratë, vajzat e trafikuara, etj.[21]. Ngritja e komisionit të vlerësimit të nevojave dhe të planifikimit të shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut ka si qëllim planifikimin e shërbimeve të reja në komunitet, duke përgatitur strategji të qarta konsultimesh dhe komunikimesh për zbatimin e tyre[22].

Numri i lartë i fëmijëve romë, të paregjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në lagjen Rrapishtë të qytetit Elbasan, është shqetësues për anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit, të cilët referuan 108 raste të tillë në takimin e radhës, të mbajtur në komisionin e vlerësimit të nevojave në Këshillin e Qqarkut të Elbasanit. Shumica e tyre janë fëmijë të lindur jashtë vendit, kryesisht në Greqi, gjatë periudhës së emigrimit të paligjshëm të prindërve të tyre. Prindërit e tyre nuk kanë dokumentet përkatës.Anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit kërkuan që komisioni të ndërmerrte hapa konkrete në drejtim të zgjidhjes së këtij problem, duke sugjeruar (po të ishte nevoja) edhe ndryshimin e legjislacionit. Sipas tyre, një fëmijë i paregjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile nuk mund t'i gëzojë të drejtat e tij dhe të përfitojë shërbimet e ofruara.

Vështirsitë e hasura

- *Mungesë e burimeve njerëzore të kualifikuara për problematikat specifike të grupeve të ndryshme në nevojë;*
- *Përfaqësim i vogël dhe nivel i ulët konsultimesh me grupet në nevojë;*
- *Mungesë buxheti për zbatimin e strategjive dhe të politikave sociale rajonale;*

3.4 Promovimi i rolit të Grupit të Këshillimit të Komunitetit në nivel kombëtar

Ndihmesa e Grupit të Këshillimit të Komunitetit, sa u përket mbrojtjes së fëmijëve dhe parandalimit të formave të ndryshme të abuzimit me ta është jetike dhe ajo duhet të kuptohet mirë nga institucionet qendrore dhe ministritë e linjës duke e bërë atë pjesë të planeve të tyre të ndërhyrjes për mbrojtjen e fëmijëve dhe duke pasur parasysh interesin e tyre më të lartë në nivel kombëtar. Vizioni dhe misioni i tyre duhet të përfshijë vlerat e punës së komunitetit, në përgjithësi, dhe rolin e këtij Grupi, në veçanti, me qëllim për t'i përqendruar përpjekjet dhe energjitë e tyre te pikat e forta dhe përparësitë e tij, për t'iu përgjigjur në kohë dhe me efikasitet sfidave lokale, rajonale dhe kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve. Ndonëse nuk ka ndonjë model, "të dhënë njëherë e përgjithmonë", që t'i përshtatet çdo situate, realiteti ose komuniteti, modeli i Grupit të Këshillimit të Komunitetit për mobilizimin e komunitetit në nevojë për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre është një produkt i formëzuar nga komuniteti që sjell zërin e tij dhe është i gatshëm që të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm, me qëllim për të pasur një "komunitet të sigurt, fëmijë të mbrojtur dhe familje të shëndetshme".

21 VKM 563, datë 12.08.2005, "Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore".
22 Strategjia e shërbimeve shoqërore (2005-2010), Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe të Shanseve të Barabarta.

Pjesë nga fjala e anëtares së Grupit të Këshillimit të Komunitetit, NISH-Tulla, Durrës, në konferencën kombëtare "Respektimi i të drejtave të minoritetit rom në Shqipëri: për një Shqipëri pa diskriminim dhe racizëm, 8 prill 2011.

Duke shfrytëzuar rastin që jam sot këtu, në këtë konferencë, si përfaqësuese e Grupit të Këshillimit të Komunitetit, NISH-Tulla Durrës, dua të theksoj se respektimi i të drejtave të minoritetit rom nuk mund të kuptohet pa respektimin e të drejtave të fëmijëve. E ky respekt duhet të nxitet nga vetë ne që duhet të japim shembullin tonë pozitiv. Përkushtimi që ne tregojmë sot në edukimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve tanë, si pjesë e rëndësishme e mbrojtjes së të drejtave të tyre, është një investim i vyer që do të rritet në vite dhe do t'i japë frytet e tij në integrimin dhe gjithëpërfshirjen sa më të madhe të fëmijëve në shoqëri. Prandaj, ju ftoj të gjithëve që të jepni kontributin tuaj në këtë drejtim.

3.5 Shkëmbim përvojash mes Grupeve të Këshillimit të Komunitetit

Çdo komunitet në nevojë ka profilin dhe dinamikat e tij, të karakterizuara nga pikat e forta dhe të dobëta, si edhe burimet e tij për të parandaluar faktorët e rrezikut dhe pasojat e tyre negative, duke përdorur ato cilësi ose veçori, për të cilat kanë nevojë fëmijët dhe familjet e tyre, me qëllim për të krijuar një komunitet të sigurt. Prandaj, ndërhyrja e përdorur përshtatet me kontekstin e komunitetit, duke përfshirë zgjedhje të rëndësishme që çojnë në arritjen e rezultateve të pritshme. Shkëmbimi i informacioneve mes anëtarëve të Grupeve të Këshillimit të Komunitetit të zonave të ndryshme ndihmon jo vetëm ndarjen e përvojave dhe të modeleve të punës në komunitet, por edhe formalizimin më të mirë të bashkëpunimit mes tyre për ta ngritur zërin bashkërisht për mbrojtjen e fëmijëve.



Shkëmbim përvojash mes Grupeve të Këshillimit të Komunitetit, Pogradec

Mendime të anëtarëve të Grupeve të Këshillimit të Komunitetit:

- *"Kjo përvojë më ndihmoi të reflektoj më mirë mbi problematikat e komunitetit rom në zona të ndryshme të vendit, për të cilat nuk kam pasur informacionin e duhur ose mundësinë për t'i parë";*
- *"Bashkimi bën fuqinë, prandaj Grupet e Këshillimit të Komunitetit duhet të bashkëpunojnë mes tyre për t'i referuar si duhet problemet e mbrojtjes së fëmijëve";*
- *"Duke shkëmbyer përvoja, e vlerësojmë veten se ku jemi dhe çfarë duhet të përmirësojmë";*

Grupi i Këshillimit
të Komunitetit
si Pjesë Përbërëse
e Rrjetit Lokal
për Mbrojtjen e Fëmijëve

4

Puna direkte me familjet në nevojë dhe komunitetin është e rëndësishme, pasi përbën gurin e themelit, me qëllim për të rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre. Por fakti se fëmijët dhe familjet jetojnë në një komunitet të caktuar nuk do të thotë se përgjegjësia për mbrojtjen e fëmijëve i takon një strukture të vetme, por të gjithë komunitetit. Ndryshimi i kulturës, të normave shoqërore të praktikave dhe të politikave për mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim për t'u ofruar shërbime të caktuara fëmijëve dhe familjeve, kërkon një angazhim terësor të atyre aktorëve që i ofrojnë shërbimet në nivel lokal, në mënyrë që t'i venë në dispozicion burimet, mjetet dhe kapacitetet e tyre, për të planifikuar një sistem shërbimi më të koordinuar dhe më të integruar, sipas nevojave të komunitetit. Përgjegjësia e përbashkët e aktorëve lokalë për të rritur sigurinë e fëmijëve në komunitet përmirëson qasjen e familjeve në nevojë te shërbimet e ofruara prej tyre dhe rrit mbështetjen e prindërve nevojtarë falë identifikimit të hershëm dhe referimit përkatës. Grupi i Këshillimit të Komunitetit, si bashkëpunëtor i vlefshëm, katalizator dhe nismëtar i ndryshimeve në komunitet, është pjesë përbërëse e bashkëveprimit me partnerët kryesorë, të angazhuar për mbrojtjen e fëmijëve, duke vendosur lidhje efektive e të qëndrueshme dhe duke shërbyer si urë lidhëse mes tyre dhe komunitetit në nevojë, për parandalimin e formave të ndryshme të keqtrajtimit, të dhunimit dhe abuzimit me fëmijët.



4.1 Bashkëpunimi me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës

Shërbimet shoqërore që ofrohen nga pushteti vendor, kanë si qëllim që të mbështesin prindërit dhe familjet, me qëllim për të ofruar një mjedis mbështetës dhe të sigurt për zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve. Në përgjithësi, fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje, vijnë nga familje me status të ulët social-ekonomik që kanë pak ose aspak informacione në lidhje me shërbimet shoqërore që ofrohen në komunitetin, ku ata banojnë. Pamundësia e fëmijëve dhe e familjeve të tyre për të vlerësuar rrezikun e mundshëm të tyre bën që fëmijët të ekspozohen ndaj formave të ndryshme të abuzimit. Bashkëpunimi i Grupit të Këshillimit të Komunitetit me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës synon jo vetëm menaxhimin e rasteve përkatëse, por edhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërgjegjësuese për fëmijët dhe familjet në nevojë.

M.D, 10 vjeç, nga qyteti i Pogradecit e lindur në Greqi, nuk është e regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile. E ëma e saj (një vajzë-nënë) e ka sjellë atë në jetë gjatë viteve të emigracionit në shtetin fqinjë dhe, në pamundësi të pagesës së detyrimit të spitalit, është larguar fshehurazi bashkë me foshnjën e saj. Aktualisht, nënë e bijë jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe janë strehuar në familjen e gjyshërve të vajzës. Vajza nuk ka ndjekur asnjë klasë, pasi gjithmonë është ngritur si problem mungesa e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile.
Ky rast u identifikua nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit që e referoi te Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës.

Çfarë u bë?

Hapat e ndjekur në menaxhimin e rastit:

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës mblodhi grupin multidisiplinar në të cilin u vendos:

- *Referimi i rastit në një OJF të specializuar në çështjet ligjore, kryesisht për të mitur, për të ofruar ndihmë ligjore për regjistrimin e vajzës në Zyrën e Gjendjes Civile;*
- *Regjistrimi i vajzës në shkollë në bashkëpunimi me Zyrën Arsimore;*
- *Përfshirja e nënës dhe vajzës në skemën e ndihmës ekonomike;*
- *Referimi i nënës te Zyra e Punës për t'u regjistruar si punëkërkuese;*

Mendime të nënës

"Regjistrimi i vajzës sime në Zyrën e Gjendjes Civile ishte diçka që e kam dashur prej kohësh, por nuk kam pasur mundësi që ta bëja vetë. Varfëria, nga njëra anë, dhe padituria për t'u marrë me letra e zyra, nga ana tjetër, ma lanë edhe vajzën pa shkollë edhe mua që të jetoj me frikën dhe pasigurinë për jetën e saj. Unë nuk mund të hapja dot asnjë librezë shëndetësore për të. Vajza ime ishte 'askush'. Falë ndihmës suaj, ajo do të ketë të drejta si fëmijët e tjerë. Do të shkojë në shkollë".

4.2 Bashkëpunimi me shkollën/psikologun shkollor

Integrimi i fëmijëve romë në shkollë dhe përshtatja e tyre me programin mësimor është përgjegjësi jo vetëm e shkollës, por edhe e komunitetit. Ky ka qenë një nga objektivat kryesorë të punës së Grupit të Këshillimit të Komunitetit, me qëllim për të rritur nivelin e përfshirjes së fëmijëve romë në sistemin arsimor parauniversitar dhe për t'i zvogëluar përmasat fenomenit të braktisjes së shkollës, sidomos në arsimin 9-vjeçar.

Komuniteti rom në Rrapishtë të qytetit Elbasan e ka pasur problem regjistrimin e fëmijëve në shkollë sepse ata nuk e dinin mirë gjuhën shqipe dhe nuk kishin frekuentuar kopshtet ose klasat parapërgatitore. Ky shqetësim u ngrit në Drejtorinë Arsimore Rajonale Elbasan dhe drejtorinë e shkollave 9-vjeçare "Hamit Mullisi" dhe "Qemal Haxhihasani" nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit, i cili kishte identifikuar 40 fëmijë që ishin në moshë për t'u regjistruar për herë të parë në klasën e parë.

Çfarë u bë?

Nën drejtimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Elbasanit dhe në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashki, drejtoritë e shkollave, psikologet e shkollave, Grupin e Këshillimit të Komunitetit dhe OJF-të lokale, u hartua plani i veprimit:

- *Ndërgjegjësimi i prindërve për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë nga anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit, në bashkëpunim me personelin mësimdhënës dhe psikologet e shkollave;*
- *Shoqërimi në shkollë i fëmijëve që do të regjistrohen në klasë të parë, nga anëtarë të Grupit të Këshillimit të Komunitetit;*
- *Caktimi i një personi ndihmës nga komuniteti rom që do të ndihmojë përshtatjen e fëmijëve romë në klasë, i financuar nga shoqata A2B;*
- *Mbështetje e fëmijëve me materiale mësimore nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashki;*
- *Mbështetje e vazhdueshme psiko-sociale e fëmijëve romë në shkollë nga psikologu shkollor;*
- *Monitorim i vazhdueshëm i frekuentimit të shkollës nga personeli mësimdhënës*

Rezultati

- *31 fëmijë rom të regjistruar në klasë të parë;*
- *shkëmbim i vazhduar informacioni me prindërit për mbarëvajtjen e fëmijëve;*
- *përshtatje e fëmijëve në shkollë dhe përfshirje e vazhduar në aktivitete të ndryshme;*

Mendime të prindërve:

- *"Falënderojmë shumë anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit që na ndihmojnë për shkollimin e fëmijëve tanë. Ne jemi fukarenj e pa shkollë, por të paktën fëmijët tanë të mos vuajnë si ne e të mos kenë fatin tonë. Ju po na i ndihmoni shumë";*
- *"Vetë punoj gjithë ditën në treg, mbeta me thasë në krahë, por jam e kënaqur që vajza ime shkon me qejf në shkollë, në klasë të parë. Unë dal herët nga shtëpia për të shkuar në treg dhe vajzën e shoqëron në shkollë një anëtare e komunitetit bashkë me disa fëmijë të tjerë";*

4.3 Bashkëpunimi me institucionet e shërbimit shoqëror rezidencial

Ndonëse sot jeta në familje është bërë komplekse, familja është vendi më i mirë për përkujdesjen e fëmijëve dhe rritjen e mirëqenies së tyre. Por kur ajo nuk e kryen si duhet përgjegjësinë e saj dhe cenon zhvillimin normal të tyre, duke rritur nivelin e pasigurisë dhe të ekspozimit ndaj formave të ndryshme të abuzimit ose të neglizhencës, atëherë, pushteti vendor me anë të sistemit të përkujdesjes shoqërore ndihmon për të zvogëluar pasojat negative te fëmijët, duke ofruar paralelisht shërbime rezidenciale për fëmijët dhe mbështetje për familjet nevojtare për fuqizimin e tyre.

M.K, 10 vjeçe nga komuniteti rom i NISH-Tulla, Durrës, u identifikua nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit si e paregjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile. Familja e saj, e përbërë nga dy prindërit dhe gjashtë fëmijë, jetonte në kushte të mjerueshme, johigjenike dhe nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për rritjen e saj. E ëma e vajzës ishte e sëmurë dhe nuk mund t'i ofronte asaj përkujdesjen e duhur, ndërsa babai bënte punë të rastit që nuk i sillnin familjes të ardhura të qëndrueshme.

Çfarë u bë?

Grupi i Këshillimit të Komunitetit e referoi rastin në institucionin e shërbimit shoqëror rezidencial në qytetin e Durrësit dhe ndoqi hapat e mëposhtëm:

- *Bashkëpunoi me prindërit e vajzës për të mbledhur dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e vajzës në Zyrën e Gjendjes Civile;*
- *Bashkëpunoi me drejtuesen e institucionit të shërbimit shoqëror rezidencial për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për ta strehuar vajzën në këtë institucion;*
- *Bashkëpunoi me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës për të ndihmuar nënën për blerjen e ilaçeve;*
- *Bashkëpunoi me fondacionin "Nehemia" për t'i përfshirë dy fëmijët e tjerë të familjes në qendrën e saj ditore, ku të hanin një vakt falas;*

Vështirësi të hasura:

- *nivel i ulët besimi i prindërve te bashkëpunimi me institucionet lokale;*
- *nivel i ulët informacioni i prindërve për shërbimet e ndryshme të ofruara në komunitet;*
- *mungesë koordinimi midis aktorëve të ndryshëm lokalë, të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve;*
- *mungesë e shërbimeve të tjera alternative në ndihmë të familjeve dhe të fëmijëve;*

4.4 Bashkëpunimi me Drejtorinë e Shërbimit Publik

Shëndeti i fëmijëve është një "e mirë publike" dhe një e drejtë e tyre themelore. Barazia në marrjen e shërbimeve shëndetësore i ndihmon ata që të gëzojnë një jetë të shëndetshme. Në të kundërt, dhuna, neglizhenca dhe braktisja e fëmijëve mund të sjellin pasoja negative në shumë aspekte të zhvillimit dhe të shëndetit të tyre si: prapambetje në zhvillimin fizik, ulje të aftësisë për të mësuar, zhvillim të sjelljeve josociale, shtatzani të padëshiruara, etj. Ky model mund të përhapet dhe të ndikojë gjithnjë e më shumë në jetën e fëmijëve dhe të anëtarëve të tjerë të familjes. Për t'i edukuar prindërit lidhur me zhvillimin fizik dhe psikomotor të fëmijëve, si edhe me metodat bashkëkohore të përkujdesit ndaj fëmijëve, Grupi i Këshillimit të Komunitetit bashkëpunoi ngushtë me Drejtorinë e Shëndetit Publik.

Probleme të ngritura nga anëtarët e komunitetit gjatë këtyre aktiviteteve:

- *Mungesë informacioni nga nënat e reja për rritjen e fëmijëve;*
- *Kontakte të vogla me punonjësit e shëndetësisë;*
- *Muangesa e kushteve higjeno-sanitare në komunitetin, ku jetojnë;*
- *Ndarja e roleve gjinore në familje dhe pozita e ulët sociale e nënave në familje për të përmbushur nevojat e fëmijëve;*

4.5 Bashkëpunimi me OJF-të lokale

Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i anëtarëve të komunitetit për të luajtur një rol aktiv në identifikimin e hershëm të formave të ndryshme të abuzimit me fëmijët dhe referimin e tyre te strukturat përkatëse duhet të shoqërohet edhe me ofrimin e shërbimeve të tjera alternative që synojnë të fuqizojnë familjen, me qëllim për t'i pakësuar shkaqet kryesore të abuzimit me fëmijët, si varfëria dhe përjashtimi shoqëror. Një nga këto mënyra është dhënia e kredive të vogla për zhvillimin e një aktiviteti ekonomik familjar, të kushtëzuar me shkollimin e fëmijëve, përkujdesjen dhe mbajtjen e tyre larg rrugës.

4.5.1 Kredia e e vogël e kushtëzuar - një model pozitiv për shkollimin e fëmijëve

Kredia e vogël për zhvillimin e aktivitetit ekonomik familjar dhe rritjen e të ardhurave të familjeve nevojtare e kushtëzuar me shkollimin dhe kujdesin për fëmijët u jepet familjeve nevojtare nga fondacioni "Terre des hommes" në bashkëpunim me shoqatën "Veprime të Përbashkëta kundër Varfërisë (CAAP) dhe institucionin financiar NOA. Gjysma e kredisë jepet falas nga fondacioni "Terre des hommes", ndërsa gjysma tjetër jepet nga NOA-ja, së cilës ajo i shlyhet, duke ia paguar pjesë-pjesë (me këste). Përfitues të kredisë së vogël të kushtëzuar mund të jetë çdo familje në gjendje të vështirë ekonomike, kryesisht nga komuniteti rom, që merret me një aktivitet të thjeshtë ekonomik dhe që: **a)** ka fëmijë në moshë shkolle dhe nuk e përballon dot shkollimin e tyre; e **b)** ka dëshirë që t'i shtojë të ardhurat e saj, duke zhvilluar një biznes të vogël familjar; e **c)** paguan rregullisht dhe në afat kështin e kredisë; e **d)** kujdeset për rritjen dhe shkollimin e fëmijëve.

4.5.1.1 Vlerësimi i nevojave të familjeve për të marrë kredi të kushtëzuar

Identifikimi i familjeve nevojtare,kryesisht nga komuniteti rom, që mund të përfitojnë kredi të kushtëzuara, bëhet nga anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit, të cilët janë informuar më parë nga ndërmjetësi i fondacionit "Terre des hommes" në komunitet mbi kriteret që duhet të plotësojë çdo familje e interesuar. Rasti i identifikuar referohet te ndërmjetësi përkatës i fondacionit "Terre des hommes", i cili zhvillon një intervistë individuale me kërkuesin e kredisë së vogël dhe plotëson formularin përkatës (*Shtojca 3*). Më pas, ky formular dërgohet te koordinatori lokal i OJF-së "Veprime të Përbashkëta Kundër Varfërisë", i cili vlerëson aftësinë e familjes së interesuar nga pikëpamja e kapaciteteve që ajo ka për të zhvilluar një aktivitet ekonomik, duke bërë edhe vlerësimin faktik të saj. Më pas, koordinatori lokal i kësaj shoqate e dërgon formularin te specialisti i kredive të institucionit financiar NOA, për të bërë vlerësimin përfundimtar të kapaciteteve dhe të burimeve të aplikuesit për të marrë kredinë e vogël. (*Shtojca 4* paraqet ciklin e këtij procesi).

Kredia e vogël e kushtëzuar është përdorur kryesisht për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të thjeshta, duke u bazuar në aftësitë konkurruese të aplikuesit në raport me tregun, përvojën e tij të mëparshme në një aktivitet ekonomik të caktuar dhe shprehitë e tij profesionale.

Profili i përfituesve të kredive të vogla të kushtëzuara:

- *58% e përfituesve janë nga qyteti kundrejt 42% të përfituesve që janë nga fshati;*
- *30% e përfituesve janë femra (kryesisht kryefamiljare);*
- *44% e përfituesve merren me tregtinë e rrobave të përdorura; 31% merren me blegtori; 8% merren me tregti artikujsh me pakicë; 5.4% merren me instrumente muzikore; 3.6% merren me zejtari; etj.;*

Vështirësitë e hasura në përfshirjen e familjeve në kredinë e kushtëzuar:

- *besim i ulët te ndihma dhe bashkëpunimi me institucionet financiare, si bankat;*
- *mungesë kulture komunikimi me zyra dhe institucione të ndryshme;*
- *mungesë informacioni për shërbimet e ofruara nga institucionet financiare;*
- *pasiguri e madhe në pagesën në kohë të kësteve;*
- *vetëvlerëim i ulët i aftësive të tyre për zhvillimin e një aktiviteti ekonomik të suksesshëm;*
- *pasiguri e madhe për shkak të diskriminimit të tregut;*

4.5.1.2 Rritja e kapaciteteve të familjes në menaxhimin e të ardhurave

Megjithë dëshirën e mirë të aplikuesve për të marrë kredi të vogla të kushtëzuara, ngritja e kapaciteteve të tyre për të menaxhuar të ardhurat, për të hartuar një plan të vogël biznesi, për ta administruar si duhet aktivitetin ekonomik, për të identifikuar vështirësitë që kufizojnë mundësitë e aktivitetit ekonomik, dhe për të kuptuar marrëdhëniet me tregun, duke analizuar faktorët e mundshëm të suksesit dhe të rrezikut, është realizuar vazhdimisht me anë të trajnimeve të ndryshme.

Trajnim i përfituesve të kredive të vogla të kushtëzuara, Elbasan

Probleme të ndeshura nga përfituesit e kredive të vogla të kushtëzuara:

- vështirësia për të gjetur treg për shitjen e produkteve të tyre rrit shpenzimet e transportit;
- mungesa e mbështetjes nga shërbimi veterinar në fshat për kontrollin e bagëtive;
- mungesë informacioni mbi kërkesë-ofertën e produkteve në treg;
- mjete transporti të vjetra ose të pasigurta për transportimin e mallrave/produkteve të tyre;
- rritje e çmimit të mekanikës bujqësore;
- nevoja për kurse profesionale më të specializuara për të përmirësuar cilësinë e produkteve për të konkurruar në treg;

Përparësitë e kredive të vogla të kushtëzuara:

- *mundësi zhvillimi të një aktiviteti ekonomik familjar;*
- *mundësi aktivizimi dhe mobilizimi të burimeve të brendshme të familjes;*
- *ulje e nivelit të varësisë nga skema të ndryshme sociale ose ndihma ushqimore të ofruara nga shoqata të ndryshme;*
- *rritje e nivelit të përgjegjësisë për të ofruar një përkujdesje e shkollim më të mirë për fëmijët;*

Rezultate të arritura:

- *56% e përfituesve pohojnë se situata e tyre ekonomike është përmirësuar pak kohë pas marrjes së kredisë së vogël, ndërsa 26% të përfituesve pohojnë se situata e tyre ekonomike është përmirësuar shumë dhe 17% të përfituesve pohojnë se ajo nuk ka ndryshuar;*
- *52 % e përfituesve pohojnë se ata i plotësojnë pak më mirë nevojat e familjes së tyre pas marrjes së kredisë, ndërsa 26% të përfituesve pohojnë se i plotësojnë ato shumë mirë dhe 22% e përfituesve pohojnë se i plotësojnë ato njësoj si më parë;*
- *100% e përfituesve pohojnë se nuk patën ndonjë problem për të plotësuar nevojat e fëmijëve të tyre për shkollim dhe 92.5% pohuan se e kanë përmirësuar kujdesin dhe ushqimin e fëmijëve*

4.5.1.3 Monitorimi i ecurisë së aktivitetit familjar dhe të shkollimit të fëmijëve

Monitorimi i ecurisë së aktivitetit ekonomik të familjeve është përqendruar jo vetëm në rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e jetesës së saj, por edhe në rritjen e kujdesit të familjeve për fëmijët, në përgjithësi, dhe shkollimin e tyre, në veçanti. Monitorimet e rregullta (një herë në dy muaj) kanë shërbyer edhe si një moment reflektimi për familjet për të parë, nëse ato i kanë përmbushur si duhet objektivat e veta për mënyrën e përdorimit të kredisë së vogël e të plotësimit të nevojave të anëtarëve të tyre dhe shkollimin e fëmijëve. Analiza e bërë nga përfituesi i kredisë gjatë procesit të monitorimit i ka shërbyer atij për të vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta të identifikuara në aktivitetin e tij ekonomik, për të gjetur strategji të reja, me qëllim për t'u përshtatur me tregun, dhe për të krijuar një mjedis më mbështetës në familje për zhvillimin, rritjen dhe edukimin e fëmijëve, duke përmirësuar ushqimin, veshjen dhe argëtimin e fëmijëve (*Shtojca 5*).

Vlerësimi i Modelit
të Ndërhyrjes

5

Modeli i ndërhyrjes së zbatuar nga fondacioni "Terre des hommes" është vlerësuar nga shumë bashkëpunëtorë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndikuan dhe u ndikuan prej tij, duke ndihmuar ndërgjegjësimin, mobilizimin dhe fuqizimin e komuniteteve në nevojë për parandalimin e formave të ndryshme të abuzimit me fëmijët dhe mbrojtjen e tyre, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe bashkëpunues në komunitet. Duke përdorur intervista individuale dhe diskutime në grup, opinionet dhe vlerësimet e mbledhura nga këndvështrime të ndryshme shërbyen për të pasur një kuptim më të qartë të ndihmesës së dhënë nga modeli i ndërhyrjes së fondacionit "Terre des hommes", duke nxjerrë në pah si pikat e forta, ashtu edhe sugjerimet për përmirësimet përkatëse.

5.1 Vlerësimi nga anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit

Anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit e vlerësojnë krijimin e grupit, pjesëmarrjen tyre në të dhe rolin e tij në komunitet si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv.

Nga ***këndvështrimi individual,*** ata nënvizojnë se falë punës së kryer për ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre me aktivitete dhe trajnime të vazhdueshme, të bazuara në nevojat e tyre, "ne *kemi mësuar për të drejtat e tona, në përgjithësi, dhe të drejtat e fëmijëve, në veçanti, duke u bërë më të ndjeshëm ndaj problemeve të tyre*" dhe "*duke kuptuar se problemet e komunitetit nuk zgjidhen në heshtje, por duke ngritur zërin*"; se " *zëri nuk duhet të jetë i veçuar, por i bashkuar*"; "*kemi ndryshuar veten tonë dhe familjet tona, kemi ndryshuar mënyrën e komunikimit në familje dhe me fëmijët tanë, gjë që ka sjellë zhvillime pozitive te fëmijët dhe të rriturit*"; "*dikur isha i turpshëm, por tani flas për problemet e komunitetit*"; "*falë trajnimeve të marra unë gjeta punë dhe u ndërgjegjësova për rolin që unë mund të luaj në komunitet*"; "*kam mësuar që të jem më tolerant, të komunikoj hapur dhe të jem aktiv në gjetjen e zgjidhjeve të problemeve të komunitetit*", "*duke kuptuar se ndryshimi duhet të vijë nga vetë neve dhe se ne duhet të jemi pjesë e tij*", etj.

Mexhidije Ademi, Grupi i Këshillimit të Komunitetit, Elbasan

"Dikur kam qenë një grua shtëpiake (nënë e tre fëmijëve) që si shumë gra rome e kaloja kohën, duke u marrë me punët e shtëpisë. Ndonëse e shihja se komuniteti ynë kishte shumë probleme, nuk isha në gjendje që të jepja ndihmën time.. nuk dija se si. Fillimisht, e pata të vështirë që të bëhesha pjesë e Grupit të Këshillimit të Komunitetit, për shkak të mentalitetit të familjes dhe këmbënguljes së burrit se' vendi i gruas është në shtëpi'. Por falë pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme, të organizuara në komunitet nga fondacioni 'Terre des hommes', unë u sqarova shumë, sqarova bashkëshortin tim dhe vendosa të bëhem pjesë e këtij grupi. E kuptoj se kam mësuar shumë, kam fituar respektin e komunitetit, kam ndryshuar veten dhe familjen. Më janë hapur sytë".

Spartak Ballkazi, Grupi i Këshillimit të Komunitetit, fshati Rom, komuna Qendër

"Unë vij nga një familje e varfër që e ka siguruar me shumë vështirësi jetesën e saj. E lashë shkollën që në moshë të vogël dhe kam bërë punë të papërshtatshme për të ndihmuar familjen time. Shpesh herë, jeta ime në rrugë ka qenë në rrezik ndaj formave të ndryshme të abuzimit. Duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme, të organizuara nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit, kuptova se edhe unë mund të ndihmoja komunitetin për të mbrojtur fëmijët dhe për të respektuar të drejtat e tyre. Duke folur vazhdimisht për fëmijërinë time të vështirë dhe pasojat e braktisjes së shkollës, i kam nxitur fëmijët e komunitetit që të shkojnë rregullisht në shkollë e të mësojnë. Pjesëmarrja ime në Grupin e Këshillimit të Komunitetit më ndihmoi që të kuptoj se, duke u nisur nga dëshira e mirë, çdo anëtar komuniteti mund të ndihmojë për të sjellë ndryshime. Ndihem i vlerësuar".

Emiljano Elmazi, Grupi i Këshillimit të Komunitetit, NISH-Tulla, Durrës

"Pjesëmarrja në Grupin e Këshillimit të Komunitetit më ndihmoi të zhvilloj jo vetëm aftësitë komunikuese, ndërmjetësuese e organizuese, por edhe të përmirësoj njohuritë mbi shërbimet e ofruara në komunitet. Në fillim, më vinte turp të flisja para të tjerëve, pasi nuk kisha shprehi dhe arsimin e duhur. Por me njohuritë e marra gjatë trajnimeve të vazhdueshme u aftësova të flas para të tjerëve dhe të organizoj aktivitete të ndryshme. Përvoja e fituar më ndihmoi të punësohem në një shoqatë rome dhe të promovoj modelin e punës së Grupit të Këshillimit të Komunitetit, duke vendosur ura bashkëpunimi midis tyre, për të organizuar aktivitete të përbashkëta për ndërgjegjësimin e komunitetit për pajisjen e fëmijëve me libreza shëndetësore dhe vaksinimin e tyre".

Nga ***këndvështrimi i ndihmesës së dhënë për komunitetin***, anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit vlerësojnë se "*kanë krijuar besim në komunitet*", "*komunikojmë me punonjësit e institucioneve publike e jopublike dhe kemi vendosur bashkëpunim të mirë me ta*", "*komuniteti i mirëpret takimet tona dhe e vlerëson ndihmën që ne i ofrojmë*", "*aktivitetet që kemi organizuar, na kanë ndihmuar që të njohim më mirë komunitetin tonë dhe të forcojmë lidhjet me njëri-tjetrin*", etj.. Por, nga ana tjetër, anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit sugjerojnë se "*puna e grupit duhet të mbështetet edhe në të ardhmen, duke e rritur numrin e anëtarëve dhe përfshirjen*

e komunitetit në zgjidhjen e problemeve të ndryshme", pasi "*ndryshimi i mentalitetit është shumë i vështirë dhe kërkon angazhim të të gjithëve*". Kjo kërkon "*një proces konsultimesh të rregullt dhe me bazë të gjerë mes shumë bashkëpunëtorëve, një komunikim të strukturuar, caktimin e një buxheti të caktuar për organizimin e aktiviteteve, si edhe ofrimin e qendrave komunitare*", etj..

5.2 Vlerësimi nga anëtarët e komunitetit

Anëtarët e komunitetit, si përfitues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të modelit të ndërhyrjes së fondacionit "Terre des hommes" e vlerësojnë ndihmesën e dhënë në disa aspekte, ku ndërthuren a) përfitimi i komunitetit, falë mobilizmit dhe ndërgjegjësimit të tij të vazhdueshëm, b) përfitimi i individëve, falë rolit të Grupit të Këshillimit të Komunitetit në organizimin e aktiviteteve ose në menaxhimin e rasteve përkatëse dhe c) përfitimi nga skema e kredive të vogla të kushtëzuara.

a. ***Nga këndvështrimi i rezultateve të arritura, falë mobilizimit dhe ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve me trajnime dhe aktivitete***, sipas anëtarëve të komunitetit, modeli i ndërhyrjes së fondacionit "Terre des hommes" ka qenë "'*gju më gju' me nevojat dhe problemet e komunitetit, duke dëgjuar zërin e tij*", "*duke nxitur ndryshimin e sjelljeve, praktikave dhe të qëndrimeve ndaj fëmijëve në favor të zhvillimit të tyre pozitiv, sepse nganjëherë ne, romët, jemi të vështirë*", "*duke inkurajuar mobilizimin dhe bashkëpunimin mes tyre, me qëllim për të parandaluar format e ndryshme të abuzimit me fëmijët", "për të rritur e për të përmirësuar rolin e familjes në mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre*", "*në afrimin e komunitetit me institucionet, pasi, në trajnimin e organizuar me mjeken, ajo na shpiegoi shumë gjëra dhe, kur unë shkova te zyra e saj për hallin e vajzës sime të sëmurë, ajo më mbajti mend dhe më ndihmoi*", "*kemi ndryshuar për mirë*", etj..

b. ***Nga këndvështrimi i rolit të Grupit të Këshillimit të Komunitetit***, anëtarët e komunitetit vlerësojnë që ata "*trokasin në dyert tona, na pyesin për problemet që kemi, na informojnë për aktivitetet që do të kryhen*"; "*na janë bërë si njerëz të shtëpisë, na ndihmojnë që të përgatisim dokumentet e duhura dhe na shoqërojnë nëpër zyra*"; "*ata më ndihmuan të regjistroj djalin në Zyrën e Gjendjes Civile, sepse unë nuk dija se çfarë të bëja*"; "*falë ndihmës së tyre, vajza ime e paralizuar 10 vjeçe mori një karrocë me rrota falas nga shoqata, ku ata e referuan, sepse unë nuk kisha mundësi që të bleja një të tillë*"; "*nga aktivitetet e tyre unë mësova se ku mund të shkoj për të denoncuar rastet e dhunës ndaj fëmijëve, se si të kujdesem për fëmijën në muajt e parë të jetës, për llojet e vaksinave që duhet t'i bëj*"; "*mësova për pasojat negative të martesave të hershme dhe të mosregjistrimit të fëmijës në Zyrën e Gjendjes Civile*", etj.. Ndonëse i shohin me optimizëm ndryshimet e kryera si rezultat i zbatimit të këtij modeli të ndërhyrjes, ata theksojnë "*nevojën për mbështetje dhe informacione suplementare, pasi i konsiderojnë ato si të domosdoshëm për integrimin e tyre në shoqëri dhe për pakësimin e diskriminimit e të përjashtimit social*".

c. ***Nga këndvështrimi i përfitimit nga skema e kredive të vogla të kushtëzuara***, anëtarët e komunitetit e vlerësojnë marrjen e tyre "*si një ndihmë shumë të madhe, pasi: "qëkur mora kredinë e vogël, nuk kam marrë më borxhe*"; "*tashmë vajza ime e divorcuar punon në treg, fiton para dhe i ka blerë rroba vajzës së saj që e kishte të veshur si mos më keq*"; "*puna më është shtuar, kam blerë shumë mall, shkoj të shes edhe në fshatra, fitoj mirë dhe fëmijëve ua plotësoj nevojat për ushqime e shkollim*"; "*me paratë që fitoj nga puna me kredinë që mora, i blej vetë ilaçet për vajzën dhe nuk kam nevojë që të m'i japë shoqata*", etj. Disa anëtarë të tjerë të komunitetit e vlerësojnë përfshirjen e tyre në marrjen e kredive të vogla "*si një mundësi të mirë për t'i përmirësuar aftësitë e tyre, me qëllim për të ndërvepruar dhe për të komunikuar me institucionet*", sepse, "*falë përvojës që patëm lidhur me marrjen e kredisë së parë, unë aplikova përsëri dhe e mora vetë kredinë e dytë pa ndihmën e fondacionit 'Terre des hommes'*", etj.

5.3 Vlerësimi nga fëmijët

Aktivitetet e organizuara nga anëtarët e Grupit të Këshillimit të Komunitetit kanë sjelljë ndryshime pozitive te sjelljet e fëmijëve, te njohuritë e tyre mbi të drejtat e tyre, te marrëdhëniet në familje e me moshatarët, zhvillimin e shprehive të reja për jetën, etj.

- *"Në festën e Elderlezit, unë mësova vallet rome që më pëlqyen shumë";*
- *"Unë e di se kur një fëmijë ka problem ose nuk vjen në shkollë, atëherë ai duhet referuar te zyra për fëmijët në bashki";*
- *"U kënaqa në kampin veror, sepse mësova shumë lojra dhe zura shokë të rinj. Mësova për të drejtat e mia";*

"Në vitet e mëparshme, kur vinte vera, unë shkoja gjithmonë me mamin dhe vëllezërit e mi në Porto Romano për të mbledhur hekurishte ose për të lypur. Ne nuk kemi shumë para, prandaj punojmë në verë për të siguruar bukën e gojës. Por, kur mora vesh se do të organizohej kampi veror dhe fëmijët e lagjes do të merrnin pjesë, unë iu luta mamit që të shkoja. Ishte hera e parë për mua që shkoja në kamp. Unë nuk kam shkuar asnjëherë në shkollë dhe në kamp mësova të vizatoj, të ngjyros, të njoh numrat dhe të mësoj germat. Mësova shumë lojra e zura shokë të rinj. Ditët më të bukura ishin ato, kur shkonim në plazh. Ajo ishte vera më e bukur për mua. Nuk do ta harroj kurrë".

5.4 Vlerësimi nga bashkëpunëtorët lokalë publikë dhe jopublikë

Si pjesë e rrjetit lokal për mbrojtjen e fëmijëve, roli i Grupit të Këshillimit të Komunitetit është vlerësuar edhe nga bashkëpunëtorët e tjerë lokalë, të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve. Ata e konsiderojnë ndihmesën e këtij grupi shumë domethënëse dhe të domosdoshme për identifikimin e hershëm të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje dhe përfshirjen e tyre në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme, duke u bazuar në interesit më të lartë të fëmijës.

5.4.1 Vlerësimi nga institucionet publike

- ***Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës***: "*Grupi i Këshillimit të Komunitetit i ka dhënë një ndihmesë të madhe zyrës sonë, pasi na ka ndihmuar që të jemi sa më pranë komunitetit dhe fëmijëve që preken nga probleme të ndryshme. Ky grup i palodhur ka shërbyer si pikë kontakti dhe ka ofruar gjithmonë mbështetjen e tij në dobi të komunitetit". "Kam marrë pjesë në disa takime,të organizuara nga Grupi i Këshillimit të Komunitetit me përfaqësues të pushtetit lokal dhe jam ndjerë mirë për nivelin e tij të lartë të ndërgjegjësimit në lidhje me problemet që shqetësojnë komunitetin dhe të drejtat e tij. Personalisht, e kam parë si diçka shumë pozitive rolin e këtij grupi, të ngritur mbi baza vullnetare, që mundohet ta transmetojë zërin e komunitetit në çdo institucion. Kam bashkëpunuar shumë me të në referimin e fëmijëve në nevojë dhe kemi kryer vizita të përbashkëta në familjet e tyre. Është diçka shumë pozitive, kur vetë anëtarët e komunitetit e kuptojnë se ndryshimi i tyre fillon nga ata vetë".*

- ***Drejtoria e Shëndetit Publik****: "Grupi i Këshillimit të Komunitetit ka qenë shumë aktiv në referimin e rasteve, kryesisht të fëmijëve, për t'i pajisur ata me libreza shëndetësore. Bashkëpunimi ynë ka qenë i suksesshëm në organizimin e fushatave të përbashkëta ndërgjegjësuese me komunitetin rom për parandalimin e shtatzanive të padëshiruara, për kujdesin që nënat e reja duhet të tregojnë për foshnjat e sapolindura, për vaksinimin dhe kujdesin parësor, etj. Ndihmesa e këtij grupi ka qenë dhe mbetet shumë e vlerësuar nga ana jonë. Shpresojmë që ajo të vazhdojë të jepet edhe në të ardhmen dhe të jetë një shembull edhe për komunitetet e tjerë".*

- ***Shkolla/psikologu shkollor:*** *"Grupi i Këshillimit të Komunitetit na ka ndihmuar që të vendosim ura komunikimi e bashkëpunimi me prindërit e komunitetit rom, ku ndodhet shkolla jonë. Kontakti me të ka qenë i vazhdueshëm sa herë që ne kemi hasur vështirësi në frekuentimin e rregullt të shkollës nga fëmijët romë. Kemi gjetur kurdoherë mirëkuptimin e tyre". "Unë e vlerësoj shumë ndihmesën e anëtarëve të Grupit të Këshillimit të Komunitetit për të regjistruar fëmijët romë në shkollë. Falë këtij bashkëpunimi, numri i fëmijëve romë të regjistruar në shkollën tonë është rritur nga viti në vit". "Vullneti që tregon ky grup për të ndihmuar anëtarët e komunitetit të tij dhe fëmijët, është vërtet për t'u vlerësuar, pasi nuk është e lehtë që vullnetarisht të marrësh përsipër detyra dhe përgjegjësi në dobi të tyre. Ky grup është një fillim i mirë".*

- ***Institucionet e shërbimit shoqëror rezidencial**: "Bashkëpunimin me Grupin e Këshillimit të Komunitetit e kemi vlerësuar shumë. Referimet e tij kanë ndihmuar disa fëmijë që të shpëtojnë nga rreziku i abuzimit. Uroj që ky model të përhapet edhe në komunitete të tjerë në nevojë".*

5.4.2 Vlerësimi nga institucionet jopublike

"*Grupi i Këshillimit të Komunitetit ka qenë shumë aktiv në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe në referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë*" (shoqata "Shtëpia e shpresës"). "*Puna me komunitetet dhe grupet në nevojë është shumë e vështirë, por, për ne, bashkëpunimi me Grupin e Këshillimit të Komunitetit ka qenë shumë i vlefshëm, pasi, për ne, ai ka shërbyer si një pikë kontakti që na ka orientuar drejt nevojave kryesore të komunitetit*" (shoqata "Në dobi të gruas'). "*Falë bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e këtij grupi, është bërë i mundur edukimi dhe arsimimi i një numri të konsiderueshëm fëmijësh nga komuniteti rom. Çdo fillim viti shkollor, ata na kanë referuar fëmijë në nevojë, të cilët i kemi regjistruar në kopshtin tonë*" (Qendra ditore "Nehemia").

Mësime të Nxjerra

1. Çdo komunitet është unik. Ai ka specifikat dhe dinamikat e tij të brendshme, prandaj modeli i ndërhyrjes për mobilizimin e fuqizimin e tij dhe për ndihmën e mbrojtjen e fëmijëve duhet të përshtatet me profilin dhe kontekstin e tij, me qëllim që t'u shërbejë pozitivisht zhvillimit të sigurt e të shëndetshëm të fëmijëve dhe bashkëpunimit të frytshëm me familjet;

2. Ashtu si në një laborator, ku bëhen eksperimente të ndryshme për të testuar rezultatin e duhur, edhe puna në komunitet kërkon krijimtari dhe vizion për të arritur objektivat e dëshiruara, duke zvogëluar barrierat e bashkëpunimit me familjet, duke sfiduar qëndrimet dhe praktikat abuzive ndaj fëmijëve, duke thyer heshtjen e komunitetit ndaj pasigurisë së fëmijëve dhe duke inkurajuar përgjegjësi kolektive për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre;

3. Ndryshimi i stereotipeve dhe i vlerave të komunitetit nuk vjen me plane të hartuara "nga lart" ose "nga jashtë komunitetit", por vjen, duke e përfshirë komunitetin në hartimin e tyre, duke dëgjuar përvojat e tij jetësore, të bazuar në kapacitetet që ai ka për kapërcimin e problemeve, duke inkurajuar pikat e tij të forta dhe duke nxitur dëshirën për ndryshime. Nëse komuniteti është pjesë e zgjidhjes së problemit, atëherë, angazhimi i tij do të jetë frytdhënës në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre;

4. Bashkëpunimi me komunitetin për mobilizimin e tij për mbrojtjen e fëmijëve kërkon vendosjen e marrëdhënieve të besimit me familjet dhe prindërit, duke gjetur një lloj ekuilibri mes përgjegjësive individuale dhe përgjegjësisë kolektive për parandalimin e formave të ndryshme të abuzimit me fëmijët. Kjo gjë nuk ka qenë e lehtë, duke pasur parasysh nivelin e lartë të përjashtimit shoqëror të komuniteteve në nevojë dhe përpjekjet e tyre të mëdha për të siguruar jetesën në kufirin e varfërisë. Elasticiteti dhe mirëkuptimi kanë qenë bashkëudhëtarë në komunikimet e herëpashershme;

5. Fuqizimi i komunitetit për ta pasur nën kontroll jetën e tij dhe jetën e fëmijëve të tij, duke njohur të drejtat e tyre dhe duke përfituar nga shërbimet e ofruara në komunitet, është rrjedhojë e një procesi të gjatë konsultimesh, këshillimesh, trajnimesh, mbështetjesh dhe monitorimesh, duke rritur kapacitetet dhe aftësitë e tyre për identifikimin e hershëm të fëmijëve në nevojë dhe referimin e tyre te strukturat përkatëse. Falë një modeli ndërhyrjeje shumëdimensionale, anëtarët e komunitetit forcojnë marrëdhëniet e tyre shoqërore dhe rrisin përgjegjësinë kolektive e vetëvlerësimin për komunitetin, ku jetojnë;

6. Bashkëpunimi i komunitetit me struktura të ndryshme publike dhe jopublike është i domosdoshëm për të pasur një sistem efektiv për mbrojtjen e fëmijëve dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që u ofrohen atyre dhe familjeve të tyre. Harmonizimi i

ndërhyrjeve të drejtpërdrejta të realizuara prej tyre, nga njëra anë, krahas nismave të tjera specifike që kanë në fokus të tyre nevojat e veçanta të fëmijëve dhe të familjeve nevojtare nga ana tjetër, ndikon në planifikimin e shërbimeve të ndryshme në komunitet me qendër fëmijën dhe interesin e tij më të lartë;

7. Mobilizimi dhe fuqizimi i komunitetit në parandalimin e formave të ndryshme të abuzimit me fëmijët do të ishte i pjesshëm, nëse pushteti vendor nuk ofron shërbimet e duhura. Mungesa e shërbimeve, kryesisht në zonat rurale, e vështirëson sistemin e referimit të fëmijëve në nevojë dhe nuk ndihmon në përmirësimin e situatës së fëmijëve dhe të familjeve të tyre;

8. Puna me komunitetin për angazhimin e tij në mbrojtjen e fëmijëve ka nevojë për infrastrukturë dhe buxhet. Mungesa e qendrave komunitare e vështirëson mbledhjen e anëtarëve të komunitetit për të zhvilluar aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese në një mjedis më argëtues dhe të ndryshëm nga mjedisi i shtëpisë. Nga ana tjetër, mungesa e buxhetit për zhvillimin e aktiviteteve i bën Grupet e Këshillimit të Komunitetit që të varen nga donatorë të ndryshëm për gjetjen e fondeve për të organizuar aktivitete në komunitet;

9. Përfshirja, ndërgjegjësimi dhe fuqizimi i fëmijëve për njohjen dhe respektimin e të drejtave të tyre janë pjesë përbërëse të krijimit të një komuniteti të sigurt. Si pjesëtarë të komunitetit dhe protagonistë të jetës së tij, ata mund ta mbrojnë më mirë veten e tyre dhe t'i ndihmojnë fëmijët e tjerë në identifikimin e hershëm të formave të ndryshme të abuzimit dhe të dhunës, nëse mobilizohen dhe informohen vazhdimisht mbi të drejtat e tyre, shërbimet e ofruara në komunitet dhe rëndësinë e referimit të rasteve përkatëse te strukturat e caktuara.

Shtojca

Shtojca 1

Profili i komunitetit

Formë për profilin e komunitetit *(Ju lutemi, plotësoni çdo pyetje për çdo burim (njerëzor, material, natyror)*		
Pyetja 1: Cilat jane burimet e komunitetit? (ju lutemi, identifikojini)		
Pyetja 2: Deri ku janë përdorur? (A) plotësisht B) mirë C) normal D) i ulët E) jo (ju lutemi, shpiegojini)		
Burimet njerëzore *(burimet njerëzore, për shembull, janë: Niveli arsimor, njohuritë dhe si të ushtrojë një profesion, pjesëmarrja në organizata, pjesëmarrja në rrjete të ndryshme)*		
Burimi	**Shpjegimi**	**A-E**
Burimet natyrore *(Burimet natyrore, për shembull, janë: frutat, lumenjtë, liqenet, ushqimi, peshku, tokat pjellore, pasuritë minerare, etj.)*		

Burimet materiale *(Burimet materiale, për shembull, janë: hapësirat për aktivitete, apartamentet, autobusat, pajisjet profesionale, si makinat qepëse, kafshët, etj.)*		

Shtojca 2

Formë monitorimi aktiviteti

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	
E dorëzuar nga:	Data:
Titulli i aktivitetit:	Nr. i aktivitetit:
Objektivat e aktivitetit:	Afati kohor:
Buxheti i përgjithshëm *(në lek):*	
Nr. gjithsej i pjesëmarrësve: *(ju lutemi, bashkëngjisni listën e pjesëmarrësve)*	
A) Grupmosha a) 3-10 vjeç: b) 10-18 vjeç: c) 18-25 vjeç: d) 25+ vjeç: B) Lidhja me përfituesin: a) Prindërit b) Familja c) Fqinji c) Të tjera (ju lutemi specifikoni)	C) Etnia: a) Shqiptar b) Rom: b) Egjiptian: d) Të tjera (ju lutemi, specifikoni): D) Nga përfituesi a) Nr. i fëmijëve në kartelat individuale: b) Nr. i fëmijëve për të hapur kartela individuale: c) Të tjera (ju lutemi, specifikoni):
ORGANIZIMI I AKTIVITETIT *(Ju lutemi, përqendrohuni në këtë pjesë të formës, sidomos mbi organizimin e aktivitetit, pa konsideruar rezultatet dhe objektivat)*	
Zhvilluar në qytetin/komunitetin:	Iniciuar nga:
Do të organizohet nga:	Mbështetur nga:
Partnerë të tjerë:	Kontributi i secilit donator/partner (përfshi fondacionin "Terre des hommes"):
Personeli gjithsej i përfshirë: *(ju lutemi, bashkëngjisni një listë me emrat, emrin e organizatës që ata përfaqësojnë, profesionin e tyre, kontaktin dhe rolin e tyre në këtë aktivitet))*	A) Organizatat a) Personeli i "Terre des hommes": b) Personel OJF/Organizatë me bazë komunitare: (*(ju lutemi. bashkëngjisni një listë me emrat, organizatat, etj.)* c) Bashkia: d) Qendrat Komunitare: e) Vullnetar: f) Biznese: g) Të tjera (ju lutemi, specifikoni):

Bashkëpunimi *(Ju lutemi, bëni një përshkrim të shkurtër të procesit të bashkëpunimit me partnerët organizues)*		
Organizimi *(ju lutemi, bëni një përshkrim të shkurtër të gjërave që ishin të lehta/të vështira për t'u organizuar, bëni një përshkrim të shkurtër të arsyes dhe dhe të mënyrës se përse u morët me këtë çështje)*		
Ju lutemi, rendisni bashkëpunimin dhe organizimin me: **A) Pozitive B) Asnjanëse, C) Zhgënjyese**	**Bashkëpunimi**	
	Organizimi	

Rezultatet e aktivitetit *(Ju lutemi. përqendrohuni në këtë pjesë të formës për rezultatet që arritët nga ky aktivitet, sipas objektivave të tij)*	
A) E përgjithshme: *(Çfarë rezultatesh u arritën?)*	**B) Specifike** *(Deri në ç'masë janë përgatitur aktivitetet e planifikuara? Ju lutemi, bëni një përshkrim të shkurtër)*
	(Deri në ç'masë do të jenë të qëndrueshëm rezultatet? Ju lutemi, bëni një përshkrim të shkurtër)

Ju lutemi, rendisni rezultatet dhe qëdrueshmërinë e tyre: **A) Të suksesshme B) Asnjanëse, C) Zhgënjyese**	*Rezultatet e arritura*	
	Qëndrueshmëria	

Buxheti *(Ju lutemi. dorëzoni buxhetin e fundit të aprovuar)*			
Buxheti i përgjithshëm *(në lek):*			
Shpenzimet gjithsej *(në lek)*:			
Shpenzimet gjithsej nga linja e buxhetit			
Linja e buxhetit:	*Njësia*	*Çmimi*	*Shpenzimet gjithsej*

Mësime të nxjerra:
(Ju lutemi, paraqitni shkurtimisht aspektet (organizative), të cilëve duhet t'iu kushtojmë rëndësi, kur të organizojmë aktivitete të tjera)

Cfarë vjen më pas?
(Ju lutemi, përmendni pikat, ku duhet të përqendrohemi në të ardhmen dhe, mundësisht, jepni disa ide për mënyrën sesi duhet të përqendrohemi)

Dokumentet e bashkëngjitur
(Ju lutemi, kontrolloni dokumentet e mëposhtëm që i duhen bashkëngjitur këtij raporti dhe të cilët duhen vënë në një dosje të caktuar)

[ ] Një përshkrim të shkurtër të aktivitetit [ ] Propozimi i aktivitetit [ ] Buxheti i aktivitetit [ ] Katër fotografi të aktivitetit, të printuara ose/dhe në CD	[ ] Lista e identifikimit [ ] Fletushka dhe postera, nëse do të bëhen [ ] Deklaratë për shtypin, nëse duhet

Shtojca 3

Formë referimi e familjes për të përfituar kredinë e kushtëzuar (Terre des hommes – CAAP - NOA)

Të plotësohet nga ekipi i Terre des hommes ose nga përfaqësuesi i tij/i partnerit

A. Zyra që e referon [ ]

B. Data e plotësimit *(dd/MM/viti)* [ ]

C. Numri i referimit të aplikuesit[23] [ ]

D. Numri i herëve të ndihmuara nga projekti *(numri i kredisë – ju lutemi, bëni llogaritjen, duke filluar nga kredia e marrë që në fazën e parë më 2010)*

1	2	3	4

E. Kredi nga NOA? *A mori kredi aplikuesi pas ndërhyrjes nga projekti?*

PO	JO

F. Arsyeja e marrjes së kredisë tjetër *Nëse po, pse mendoni se përfituesi ka nevojë për kredi tjetër?* [ ]

1. TË DHËNA PERSONALE

Aplikuesi *(emri/emri i babait/mbiemri)* [ ] **Gjinia: Mashkull** [ ] **Femër** [ ]

Pasaporta/karta identitetit Po [ ] **Jo** [ ] **Nëse po, shkruani numrin** [ ]

Datëlindja*(dd/MM/viti)* [ ] **Vendlindja***(qyteti/fshati)* [ ]

23 Numri i referimit është i përbërë nga dy germa kapitale dhe katër numra. Dy germat e para kapitale kanë të bëjnë me rrethin, ku banon aplikuesi, pastaj vijnë dy numra që përdoren për vitin kalendarik. Dy numrat e fundit rriten në mënyrë progresive. Për shembull, nëse aplikuesi është nga rrethi i Elbasanit dhe aplikon për here të parë më 2010, numri i tij i referimit është: EL 10 01

Arsimi *(vite shkolle)* ☐ **Statusi civil** *(beqar/i martuar/i divorcuar/i ve (etj.)* ☐

Employed: Yes ☐ **No** ☐ **If yes, mentioned where** ☐

Adresa e shtëpisë: ☐

2. TË DHËNA MBI FAMILJEN

2.1 Të dhëna mbi bashkëshortin/bashkëshorten

Bashkëshorti/bashkëshortja *(emri, mbiemri)* ☐ **Mosha** ☐

Pasaporta/karta e identitetit: Po ☐ **Jo** ☐ **Nëse po, shkruaj numrin** ☐

I punësuar: Po ☐ **Jo** ☐ **Nëse po, ku** ☐

2.2 Të dhëna mbi fëmijët

Emri	**Mbiemri**	**Datëlindja** *(dd / MM / viti)*	**Gjinia** *(M / F)*	**Numri personal** *(nëse është e mundur)*	**I regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile** *(Po / Jo)*	**Shkon në shkollë** *(Po / Jo)*

2.3 Kushtet e jetesës

Kushtet e jetesës së familjes ☐

Informacion tjetër ☐

2.4 Qëllimi i kredisë së kushtëzuar dhe motivimi i familjes për të zhvilluar aktivitet ekonomik

Pikat e forta të familjes dhe motivimi ☐

3. TË DHËNA MBI AKTIVITETIN EKONOMIK (Të plotësohet nga CAAP-i)

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit ekonomik

Klientët *(të rinj, gra, nxënës, fëmijë, etj.)*

Vendi i aktivitetit *(rrugë, treg ditor, ambient me qira, etj.)*

Njësi të prodhuara/të shitura *(në muaj)* **Kosto për njësi** **Çmimi i shitjes për njësi** *(në lekë)*

Njësitë/sasia e shitur *(në muaj)* **Numri total i personave të punësuar**

Persona të punësuar *(radhiti me emër dhe mbiemër)*

4. TË DHËNA MBI KREDINË

Shuma e kredisë që nevojitet **Qëllimi**

4.1 TË DHËNA MBI KOLATERALIN

Pasuri e paluajtshme: Toka **Shtëpi** **Ndërtesë** **Të tjera** *(specifiko)*

Pasuri e luajtshme: Pajisje **Të tjera** *(specifiko)*

Nuk ka nevojë për kolateral për këtë kredi

Kolaterali në para **Kredia e mëparshme** *(shuma në lekë)*

Afati *(Nr. i ditëve/muajve/viti)* **Emri i institucionit** *(Banka Pro-Credit, etj.)*

Ndima teknike e nevojshme

5. FORMA E REFERIMIT NGA PËRFAQËSUESI I CAAP-it

Emri i referuesit **Data e referimit** (dd/MM/viti)

6. VENDIMET PËRFUNDIMTARE *(JU LUTEMI, NDANI SHUMËN E KREDISË SË MËSIPËRME 50% ME 50% MIDIS TERRE DES HOMMES DHE NOA, KUR MERRNIN VENDIMIN)*

Rekomandime nga përfaqësuesi i Terre des hommes	**Mendime nga koordinatori rajonal i CAAP-it**	**Mendime të NOA-së**
		Shuma e miratuar:
	Vendimi i zyrës qendrore të CAAP-it: Shuma e miratuar:	Data e miratimit:
	Data e miratimit:	Arsyeja për refuzimin:
	Arsyeja e refuzimit:	
Emri i përfaqësuesit të Terre des hommes:	Emri i përfaqësuesit të CAAP-it:	Emri i përfaqësuesit të NOA-së:

Shtojca 4

Cikli i procesit të kredisë së vogël të kushtëzuar



Tdh: Terre des hommes;
CAAP: Veprime të Përbashkëta Kundër Varfërisë
NOA: Institucioni financiar

Shtojca 5

Formë monitorimi

Zyra [ ] **Data e plotësimit** *(dd/MM/vit)* [ ]

Aplikuesi (Emri/mbiemri) [ ] **Aktiviteti ekonomik** [ ]

Data e marrjes së kredisë së vogël *(dd/MM/viti)* [ ]

Numri i kredive të vogla të marra:	1	2	3	4

1. TË ARDHURAT DYMUJORE *(Sa lekë nxjerr në muaj përfituesi = SHITJE - KOSTO)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

2. INVESTIMI *(Çfarë bletë me të ardhurat dhe sa shpenzuat për çdo blerje?)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

3. PAGESA E KREDISË *(përgjigjuni me po ose jo)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

Nëse jo, pse [ ]

5. VARËSIA NGA PROJEKTI *(a mund të vazhdojë përfituesi pa ndihmën e projektit)*

Po [ ] **Jo** [ ] **Nëse jo, pse** [ ]

Nëse po, pse [ ]

6. PUNËSIMI *(a ka punësuar përfituesi ndonjë person tjetër në aktivitetin e tij ekonomik duke përfshirë anëtarët e familjes?)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

7. AFTËSI TË REJA TË FITUARA *(çfarë aftësish të reja fitoi përfituesi gjatë aktivitetit, për shembull mbajtjen e llogarive, etj.)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

8. LIDHJE TË REJA ME BIZNESE TË TJERA LOKALE *(bashkëpunime të reja që ka krijuar përfituesi/ përfituesja, për shembull, vendi ku shkon për të blerë mallin e tij, për të bërë riparime të caktuara, për të shitur produktet e tij/saj)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

9. PËRMIRËSIME TË TJERA *(për shembull, ushqim më i mirë, më shumë rroba për fëmijët, pagim i siguracionit shoqëror vullnetar dhe i pagesës së pensionit – bëjeni këtë pyetje gjashtë muaj pas aktivitetit ekonomik)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

10. NDRYSHIME NË AKTIVITETIN E VOGËL EKONOMIK *(për shembull, aktivitet ekonomik i ri, ndërtesë e re, pajisje të reja, përdorim sistemi për mbajtjen e llogarive)*

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

11. ECURIA E NDJEKJES SË SHKOLLËS NGA FËMIJËT

Monitorimi i parë		**Monitorimi i dytë**		**Monitorimi i tretë**	
Monitorimi i katërt		**Monitorimi i pestë**		**Monitorimi i gjashtë**	

12. KOMENTE TË TJERA

Terre des hommes Albania

Rruga "Faik Konica", Vila 19
PO Box 7426, Tirana - Albania
Tel/Fax: +355 (0) 42 46 88 11
Email: info@tdhalbania.org
Web: www.tdh-childprotection.org / www.tdh.ch

Find us on Facebook Terre des hommes Albania
Google+ Terre des hommes Albania
twitter @TdhAlbania